LIGJ
Nr.10 331, datë 14.10.2010

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË KREDISË SË EKSPORTIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, DHE UNICREDIT BANK AUSTRIA AG PËR FINANCIMIN E MODERNIZIMIT TË 6 SPITALEVE RAJONALE KRYESORE (PËRMIRËSIMI I IMAZHERISË DIAGNOSTIKE)"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e kredisë së eksportit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e modernizimit të 6 spitaleve rajonale kryesore (përmirësimi i imazherisë diagnostike)".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6737, datë 21.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE KREDIE EKSPORTI

HUA E BUTË NR.230 247 PËR NJË SHUMË PREJ 5 958 000 EUR0

E DATËS …… 2010

E LIDHUR NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, QË VEPRON NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE E PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE (SI "HUAMARRËSI") DHE UNICREDIT BANK AUSTRIA AG (SI "HUADHËNËSI") NË LIDHJE ME FINANCIMIN E PËRMIRËSIMIT TË PAJISJEVE MJEKËSORE PËR 6 SPITALE RAJONALE NË SHQIPËRI

Kjo Marrëveshje kredie eksporti për një hua të butë nr.230.247 në një shumë prej 5 958 000 euro (Marrëveshja), e datës … 2010 është lidhur ndërmjet Huamarrësit të përcaktuar në aneksin 1 (Huamarrësi) dhe Huadhënësit (Huadhënësi) të përcaktuar në aneksin 1.

1. PËRKUFIZIME

Në këtë Marrëveshje dhe në anekset e saj, shprehjet e mëposhtme kanë kuptimet e mëposhtme:

"Datë pranimi" nënkupton datën në të cilën kjo Marrëveshje është nënshkruar nga të dyja palët dhe është ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

"Aneks" nënkupton një aneks të kësaj Marrëveshjeje, termat e të cilit konsiderohen të përfshira në këtë Marrëveshje dhe përbëjnë pjesë të saj.

"Periudhë e disponueshmërisë" nënkupton periudhën e përcaktuar në aneksin 3, gjatë së cilës huamarrjet mund të tërhiqen nga shuma e kredisë.

"Huamarrje" nënkupton një shumë të tërhequr nga Huamarrësi nga shuma e kredisë.

"Ditë pune" nënkupton një ditë në të cilën bankat janë të hapura për punë dhe transaksionet dhe depozita në valutë të huaj midis bankave mund të zhvillohen në Vjenë dhe Tiranë.

"Datë e mbylljes" nënkupton datën e përcaktuar në seksionin 7 të kësaj Marrëveshjeje.

"Shuma e kredisë" nënkupton shumën e përcaktuar në aneksin 3, nga e cila Huamarrësi mund të tërheqë huamarrje gjatë periudhës së disponueshmërisë.

"EURO" ose "€" monedha e vetme e shteteve anëtare të Bashkimit Europian që miratojnë euron si monedhën e tyre, në përputhje me legjislacionin e Komunitetit Europian në lidhje me Bashkimin Monetar dhe Ekonomik Europian.

"EURIBOR" nënkupton nivelin e përqindjes në vit të barabartë me vlerën për pagesë të menjëhershme mbi bazën e rregullit 365/360 të nivelit mesatar të depozitave EURIBOR, të rëna dakord me EURIBOR FBE (faqe 248) për një periudhë të barabartë me periudhën për të cilën interesi duhet të caktohet nga Huadhënësi (seksioni 3.3.), në ose rreth orës 11:00 të Brukselit në ditën e dytë të punës para fillimit të periudhës përkatëse të interesit. Në këtë kontekst, "FBE" nënkupton "Federation Bancaire Europeenne".

"Llogari shume" nënkupton llogarinë e hapur në emër të Huamarrësit, në përputhje me dispozitat e seksionit 2.3.

"Data të pagesës së interesit" nënkupton datat 31 mars, 30 qershor, 30 shtator dhe 31 dhjetor të çdo viti, me kusht që nëse një datë e tillë nuk është ditë pune, referencat ndaj kësaj date do të jenë të ditës së punës pararendëse.

"Periudhë interesi" nënkupton një periudhë: i) që fillon në datën e Huamarrjes ose në ditën e fundit të periudhës së saj të mëparshme të interesit; dhe ii) që mbaron më 31 mars, 30 qershor, 30 shtator ose 31 dhjetor të çdo viti.

"E drejta e mbajtjes" nënkupton çdo hipotekë, detyrim, peng, të drejtë mbajtjeje, hipotekim, barrë, ruajtje titulli ose ndonjë interes tjetër garancie të çdo lloji dhe që kanë lindur në çfarëdolloj mënyre.

"Hua" nënkupton shumën e principalit të përgjithshëm të huamarrjeve të parapaguara, sipas shumës së kredisë dhe që janë të papaguara për kohën në vazhdim.

"Data të shlyerjes së detyrueshme" nënkupton datat e çdo viti të caktuara në aneksin 3, me kusht që nëse një datë e tillë nuk do të jetë ditë pune, referencat ndaj kësaj date do të jenë ndaj ditës së punës pararendëse.

"OeKB" nënkupton Oesterreichische Kontrollbank Aktiengesellschaft, Am Hof 4, A-1011 Vienna, Austria, që vepron si agjenci e kredisë së eksportit për dhe në emër të Republikës së Austrisë.

"Garanci e OeKB-së" nënkupton një garanci të lëshuar nga OeKB-ja si agjent i Republikës së Austrisë.

"Procedurë pagese" nënkupton procedurën për pagesën e huamarrjeve të përcaktuara në aneksin 4.

"Projekt" nënkupton projektin e përcaktuar në aneksin 2.

"Blerës i projektit" nënkupton blerësin e projektit të përcaktuar në aneksin 2.

"Eksportues i projektit" nënkupton eksportuesin austriak të përcaktuar në aneksin 2.

"Datë e pranimit të përkohshëm" nënkupton datën në të cilën Huadhënësi ka marrë nga eksportuesi i projektit kopjen e COHO-s (që përcaktohet në Marrëveshjen e blerjes).

"Marrëveshje blerjeje" nënkupton marrëveshjen në lidhje me projektin të lidhur ndërmjet eksportuesit të projektit dhe blerësit të projektit dhe të përcaktuar në aneksin 2.

"Seksion" nënkupton një seksion të kësaj Marrëveshjeje.

2. SHUMA E KREDISË

2.1 Preambulë

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të parashtrojë termat dhe kushtet, në bazë të të cilave Huadhënësi financon 100% të vlerës së përgjithshme të kontratës (por deri në shumën maksimale të përcaktuar si "Shuma e kredisë" në aneksin 3 të kësaj Marrëveshjeje), që duhet të paguhet nga blerësi i projektit për eksportuesin e projektit sipas Marrëveshjes së blerjes.

2.2 Shuma e kredisë

Me anë të kësaj Marrëveshjeje, Huadhënësi bie dakord t'i vërë në dispozicion Huamarrësit shumën e kredisë gjatë periudhës së disponueshmërisë, në bazë të termave dhe kushteve të parashtruara në këtë Marrëveshje, me kusht që një huamarrje mund të realizohet vetëm nga Huamarrësi sipas shumës së kredisë, në përputhje me procedurën e pagesës së përcaktuar në aneksin 4 dhe aplikohet për pagesën e çmimit të kërkueshëm për eksportuesin e projektit sipas Marrëveshjes së blerjes.

Kredia e dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje jepet nën dhe sipas dispozitave të rregullave dhe rregulloreve për kreditë e eksportit, të shpallura nga Republika e Austrisë. Huamarrësi vlerëson se financimi mbështetet nga fondet e ndihmës publike me një element granti prej 35,23% (tridhjetë e pesë pikë njëzet e tre për qind).

Huadhënësi mund të refuzojë të livrojë një huamarrje nëse kjo huamarrje dhe interesi mbi të nuk do të mbuloheshin nga garancia e lëshuar nga OeKB-ja për dhe në emër të Republikës së Austrisë, në përputhje me ligjin mbi promovimin e eksportit të vitit 1981, të ndryshuar, dhe/ose marrëveshja e rifinancimit me OeKB-në për shumën e kredisë pushon së qeni në fuqi.

2.3 Llogaria e shumës

Huadhënësi hap një llogari me shumën në euro në emër të Huamarrësit, e quajtur "Llogaria e shumës". Çdo huamarrje e bërë sipas kësaj Marrëveshjeje debitohet në llogarinë e shumës, në përputhje me këtë Marrëveshje, e vlefshme në datën e pagesës të kësaj huamarrjeje. Rrjedhimisht, shlyerjet dhe parapagesat aplikohen në llogarinë e shumës.

2.4 Pavarësia e Marrëveshjes dhe e Marrëveshjes së blerjes

Kjo Marrëveshje dhe Marrëveshja e blerjes janë marrëveshje të veçanta dhe të pavarura. Asnjë paaftësi e eksportuesit të projektit për të përmbushur detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së blerjes nuk cenon detyrimet e Huamarrësit ndaj Huadhënësit, as nuk e bën Huadhënësin përgjegjës për ndonjë paaftësi të eksportuesit të projektit dhe/ose ndonjë pale tjetër të Marrëveshjes së blerjes.

3. INTERESI

3.1 Interesi mbi llogarinë e shumës

Huamarrësi paguan interes në datat e pagesës së interesit në një normë fikse të përcaktuar në aneksin 3, të llogaritur mbi shumën e papaguar të kredisë.

3.2 Llogaritja dhe data për pagesën e interesit

Interesi i kërkueshëm në përputhje me seksionin 3.1 rritet ditë pas dite, llogaritet mbi bazën e numrit aktual të ditëve të kaluara për periudhën përkatëse të interesit dhe një vit prej 360 ditësh dhe përveç kur parashikohet në seksionin 6.1, do të paguhet çdo tre muaj pas afatit nga Huamarrësi për Huadhënësin në datat e pagesës së interesit.

3.3 Kamatëvonesa

Në rast të paaftësisë së Huamarrësit për të paguar në datën e kërkueshme çdo shumë të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi do të paguajë interes mbi këtë shumë nga data e kësaj paaftësie pagese deri në datën e pagesës aktuale në normën e përcaktuar në aneksin 3. Kamatëvonesa sipas këtij seksioni 3.3 do të jetë e kërkueshme në datat e pagesës së interesit.

4. TARIFAT DHE SHPENZIMET

4.1 Tarifa e angazhimit

Për periudhën që fillon në datën e mbylljes dhe që përfundon në fund të periudhës së Disponueshmërisë, Huamarrësi i paguan Huadhënësit një tarifë angazhimi në normën e përcaktuar në aneksin 3. Tarifa e angazhimit e kërkueshme në përputhje me këtë seksion 4.1, llogaritet mbi bazën e numrit aktual të ditëve të kaluara dhe një viti prej 360 ditësh nga Huadhënësi mbi balancën e patërhequr të shumës së kredisë në fillim të çdo tremestri kalendarik dhe paguhet pas afatit nga Huamarrësi për Huadhënësin në datat e pagesës së interesit. Pagesa e parë e tarifës së angazhimit sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhet në datën e pagesës së parë të interesit pas datës së mbylljes.

4.2 Tarifa e drejtimit

Brenda 30 ditëve kalendarike pas datës së mbylljes (por jo më vonë se 5 ditë pune para livrimit të parë të shumës së kredisë), Huamarrësi do t'i paguajë Huadhënësit tarifën e drejtimit të përcaktuar në aneksin 3.

4.3 Shpenzimet

i) Huamarrësi i paguan më tej Huadhënësit, sipas kërkesës, shpenzimet e arsyeshme dhe të dokumentuara (duke përfshirë shpenzimet ligjore, të përkthimit dhe të udhëtimit, dhe shpenzimet në lidhje me garancinë e OeKB-së), të shkaktuara nga Huadhënësi në kërkesëpadinë për zhdëmtim ose kompensim të ndonjë shume të kërkueshme për Huadhënësin sipas kësaj Marrëveshjeje.

ii) Të gjitha taksat, tatimet, shpenzimet ose tarifat e tjera të vendosura për Huadhënësin nga Ministria e Financave, Shqipëri, në lidhje me këtë Marrëveshje dhe transaksionet e parashikuara sipas kësaj Marrëveshjeje, janë për llogari të Huamarrësit dhe të pagueshme nga Huamarrësi për Huadhënësin.

4.4 Primi i garancisë

Sipas Marrëveshjes, Huadhënësi i faturon Huamarrësit një kompensim për prim të garancisë së OeKB-së në mënyrën e mëposhtme:

i) Primi i garancisë së OeKB-së dhe tarifa e trajtimit të OeKB-së të pagueshme të parapaguar

Brenda 30 ditëve kalendarike pas datës së mbylljes (por jo më vonë se 5 ditë pune para livrimit të parë të shumës së kredisë), Huamarrësi do t'i paguajë Huadhënësit një pjesë të parapaguar për kompensimin për primin e garancisë së OeKB-së dhe tarifën e trajtimit, të përcaktuar në aneksin 3 në shumat e përcaktuara në aneksin 3.

ii) Primi i garancisë së OeKB-së i pagueshëm si marzh

Duke filluar nga data e pagesës së interesit që bie pas datës së mbylljes, Huamarrësi do t'i paguajë Huadhënësit kompensimin për primin e garancisë së OeKB-së të pagueshme si marzh, të përcaktuar në aneksin 3. Marzhi i primit të garancisë së OeKB-së është i kërkueshëm dhe i pagueshëm çdo tre muaj në datat e pagesës së interesit.

Grafiku i pagesës së shumave që duhet të paguhen sipas seksionit 4.4, përcaktohet në garancinë përfundimtare të lëshuar nga OeKB-ja. Huadhënësi informon Huamarrësin përkatësisht për lëshimin e garancisë dhe grafikun e pagesës dhe ky njoftim bëhet pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Nëse gjatë afatit të Marrëveshjes së eksportit të kredisë, primi i garancisë së OeKB-së rritet, sepse: i) vlerësimi i rrezikut komercial i kryer nga OeKB-ja, në lidhje me lëshimin e garancisë

së OeKB-së ka ndryshuar; ose ii) ndryshimet materiale në termat kontraktualë të Marrëveshjes së kredisë së eksportit janë miratuar, Huamarrësi do të riimbursojë Huadhënësin për këtë rritje, sipas kërkesës.

5. SHLYERJA

5.1 Shlyerja e detyrueshme

Huaja e papaguar në fund të periudhës së disponueshmërisë do të shlyhet nga Huamarrësi në një numër këstesh të barabarta gjashtëmujore shlyerjeje në datat e shlyerjes së detyrueshme, të përcaktuara në aneksin 3. Brenda 15 ditëve kalendarike pas datës së pranimit të përkohshëm, Huadhënësi do të njoftojë Huamarrësin për listën e datave të shlyerjes së detyrueshme dhe shumat e kërkueshme në secilën prej këtyre datave.

5.2. Parapagimi opsional

Huamarrësi mund të parapaguajë të gjithën ose ndonjë pjesë (në rast të parapagimit të pjesshëm, në shumën e përcaktuar në aneksin 3 ose shumëfishat integralë të saj) të huas, pas dhënies së një njoftimi me shkrim të paktën 30 (tridhjetë) ditë para (ky njoftim duhet të jetë i parevokueshëm) për datën e propozuar të parapagimit për Huadhënësin, në bazë të miratimit të OeKB-së dhe pagesave të ndonjë kostoje të barabartë me humbjen e llogaritur, të shkaktuara nga Huadhënësi. Çdo parapagim i tillë, nëse bëhet gjatë periudhës së disponueshmërisë, do të zvogëlojë shumën e kredisë me një shumë të barabartë me këtë parapagim. Çdo referencë ndaj shumës së kredisë në këtë Marrëveshje konsiderohet më pas të jetë referencë ndaj shumës së përcaktuar në aneksin 3, të zvogëluar. Çdo parapagim i tillë, nëse bëhet pas skadimit të periudhës së disponueshmërisë, do të aplikohet për të zvogëluar me shuma të barabarta kështet e shlyerjes së kërkueshme më pas.

6. PAGESAT

6.1 Njoftimi i pagesës

Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike para çdo date të pagesës së interesit ose sipas rastit, datës së shlyerjes së detyrueshme, Huadhënësi do të njoftojë Huamarrësin për ato shuma që janë të kërkueshme për t'u paguar nga Huamarrësi për Huadhënësin, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje në lidhje me principalin, interesin dhe tarifën e angazhimit, me kusht që paaftësia për dhënien e këtij njoftimi të lartpërmendur të mos lehtësojë Huamarrësin nga detyrimi i tij për të kryer pagesa të këtyre shumave të lartpërmendura kur ato bëhen të kërkueshme.

Njoftimi përcakton, gjithashtu, për secilën pagesë që duhet të bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje, shumën e saktë dhe qëllimin e pagesës (caktimi për shumat e kërkueshme dhe të pagueshme të njoftuara nga Huadhënësi) dhe Huamarrësi kryen pagesën në mënyrën e rekomanduar dhe konfirmon kërkesën me shkrim për fonde. Huamarrësi këshillon Huadhënësin me shkrim për qëllimin e pagesës (caktimi i fondeve) për çdo shumë të paguar nga Huadhënësi. Nëse nuk është marrë asnjë informacion i tillë, zbatohet seksioni 6.6.

Nëse ciladolloj shume debitohet dhe/ose kreditohet në llogarinë e shumës dhe/ose çdo llogari tjetër që mund të hapet në lidhje me këtë Marrëveshje në çdo kohë brenda pesëmbëdhjetë ditëve kalendarike para çdo date të pagesës së interesit, interesi ose çdo shumë tjetër e kërkueshme në lidhje me të cilën në këtë datë të pagesës së interesit, do të mbarten dhe do të bëhen të kërkueshme dhe të pagueshme për Huadhënësin në datën e ardhshme pasuese të pagesës së interesit (në rast të shumave të krediturara) do të rillogariten përkatësisht në datën e ardhshme pasuese të pagesës së interesit.

6.2 Metoda e pagesës

Në çdo datë të pagesës së interesit, data e shlyerjes së detyrueshme ose çdo datë tjetër e kërkueshme për pagesën e çdo shume të kërkueshme dhe të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, sipas rastit, Huamarrësi do të kryejë pagesën e shumave dhe monedhës së kërkueshme në këtë datë nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje në Vjenë, e vlefshme në datën e kërkueshme përkatëse.

Të gjitha pagesat nga Huamarrësi për Huadhënësin të shumave të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhen në Vjenë në euro, lirisht të konvertueshme dhe të transferueshme.

6.3 Heqja dorë nga kompensimi ose kundërkërkesa

Huamarrësi heq dorë nga secila dhe të gjitha të drejtat e kompensimit ose kundërkërkesës që mund të ketë në lidhje me ndonjë shumë të kërkueshme për Huadhënësin, sipas kësaj Marrëveshjeje dhe bie dakord që nuk do të mbajë pagesë për çfarëdolloj arsyeje të ndonjë shume të kërkueshme për t'u paguar. Në veçanti, Huamarrësi nuk do të mbajë pagesa të shumave të kërkueshme për Huadhënësin sipas kësaj Marrëveshjeje për arsye se ai ka ndonjë pretendim, të drejtë padie, të drejtë të ligjshme ose kërkesa kundër eksportuesit të projektit ose elemente të tjera në lidhje me projektin.

6.4 Pagesat pa taksa të mbajtura dhe tarifa të tjera

Të gjitha pagesat që duhet të bëhen nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhen pa kompensim ose kundërkërkesë dhe do të jenë të lira nga dhe pa zbritje për ose në llogari të çdo takse, tatimi, shume të zbritur ose të mbajtur ose tarifa të tjera të tashme ose të ardhshme të cilësdolloj natyre të Republikës së Shqipërisë nëse Huamarrësit nuk i kërkohet sipas ligjit ta bëjë këtë zbritje. Nëse kërkohet me ligj, shuma e kërkueshme nga Huamarrësi në lidhje me këtë pagesë do të rritet në shkallën e nevojshme për të garantuar që pas kësaj zbritjeje të taksave, tatimeve, shumave të zbritura, të mbajtura ose tarifave të tjera, Huadhënësi merr në datën e kërkuar për këtë pagesë një shumë neto të barabartë me shumën që do të kishte marrë nëse kjo zbritje e taksave, tatimeve, shumave të zbritura, të mbajtura ose tarifave të tjera nuk do të ishte kërkuar të bëhej. Huamarrësi do t'i japë menjëherë Huadhënësit fatura, vërtetime ose dëshmi të tjera që provojnë shumat (nëse ka) të paguara ose të pagueshme në lidhje me ndonjë shumë të lartpërmendur të zbritur ose të mbajtur.

6.5. Kostot e rritura

Nëse rezultati

- i një ndryshimi në, ose prezantimit të ndonjë ligji, rregulloreje ose kërkese rregullatore ose ndryshimit në interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje; ose

- i pajtueshmërisë së Huadhënësit me ndonjë udhëzim, kërkesë ose kusht (që ka fuqinë e ligjit apo jo) të ndonjë banke qendrore, autoriteti monetar, rregullator ose autoriteti tjetër

(duke përfshirë, në çdo rast, pa kufizim, ato që kanë lidhje me mjaftueshmërinë e kapitalit, likuiditetin, asetet rezervë dhe depozitat e veçanta) është:

a) të rrisë koston ose të vendosë një kosto shtesë për Huadhënësin në vënien në dispozicion ose ruajtjen e angazhimit të tij ose mbajtjen ose financimin e huas; dhe/ose

b) të zvogëlojë shumën e pagueshme ose kthimin efektiv për Huadhënësin sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe/ose

c) të zvogëlojë normën e kthimit të Huadhënësit mbi kapitalin e tij të përgjithshëm për shkak të një ndryshimi në mënyrën në të cilën ai kërkohet për të alokuar burimet e kapitalit për detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe/ose

d) t'i kërkojë Huadhënësit të bëjë një pagesë ose të paraprijë një kthim mbi ose të llogaritur duke iu referuar çdo shume të marrë ose që duhet të merret nga ai sipas kësaj Marrëveshjeje,

atëherë Huamarrësi do t'i paguajë Huadhënësit, sipas kërkesës, një kosto, ulje, pagesë ose kthim të tillë të paracaktuar.

Çdo vërtetim i Huadhënësit për këtë kosto, ulje, pagesë ose kthim të paracaktuar, në mungesë të një gabimi të hapur, do të jetë provë e pakundërshtueshme dhe detyruese për Huamarrësin.

Për qëllim të kësaj klauzole, Huadhënësi në mirëbesim mund të alokojë ose shpërndajë kostot dhe/ose humbjet mes aktivëve dhe pasivëve të tij (ose ndonjë kategorie të tyre) mbi atë bazë që e çmojnë të përshtatshme.

6.6 Caktimi i pagesave

Të gjitha pagesat e marra nga Huadhënësi nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje (nëse Huadhënësi nuk ndryshon urdhrin e aplikimit), duhet të aplikohen nga Huadhënësi kundrejt pagesës së shumave të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje në rendin e mëposhtëm dhe Huamarrësi bie dakord për aplikimin e këtyre pagesave me këtë rend (dhe për çdo ndryshim të tyre nga Huadhënësi):

a) shumat e kërkueshme sipas seksionit 4.2 (tarifa dhe shpenzimet e drejtimit);

b) shumat e kërkueshme sipas seksionit 4.3 (primi i garancisë së OeKB-së);

c) shumat e kërkueshme sipas seksionit 4.1 (tarifa e angazhimit);

d) shumat e kërkueshme sipas seksionit 3.3 (kamatëvonesa);

e) shumat e prapambetura sipas seksionit 3.1 (interesi);

f) shumat e prapambetura sipas seksionit 5.1 (shlyerja e detyrueshme);

g) shumat e kërkueshme sipas seksionit 3.1 (interesi);

h) shumat e kërkueshme sipas seksionit 5.1 (shlyerja e detyrueshme);

i) shumat e kërkueshme sipas seksionit 5.2 (parapagimi opsional).

Huadhënësi këshillon Huamarrësin rreth aplikimit të fondeve. Shumat e prapambetura shlyhen para shumave të kërkueshme. Çdo udhëzim për të kundërtën, i dhënë nga Huamarrësi, nuk merret në konsideratë.

Huamarrësi pranon që sipas garancisë së OeKB-së të ketë rezervuar ndaj Huadhënësit të drejtën për të ndryshuar caktimin e pagesave të përcaktuara më sipër. Në këtë rast Huadhënësi do të informojë menjëherë Huamarrësin me shkrim dhe Huamarrësi do të pranojë caktimin e OeKB-së dhe në këtë mënyrë do të marrë përsipër të shlyejë huan dhe çdo shumë tjetër të papaguar sipas kësaj Marrëveshjeje të njoftuar në atë kohë (duke përfshirë një llogaritje të hollësishme) nga Huadhënësi për Huamarrësin.

7. KUSHTET PARAPRAKE

Kjo shumë kredie do të vihet në dispozicion për Huamarrësin në datën (data e mbylljes) kur Huamarrësi merr njoftim nga Huadhënësi se kushtet e mëposhtme janë përmbushur në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Huadhënësin:

i) Huadhënësi do të ketë marrë:

a) një kopje të Marrëveshjes së blerjes të pranueshme në formë dhe të pranueshme për Huadhënësin, së bashku me një vërtetim nga eksportuesi i projektit në një datë jo më shumë se katërmbëdhjetë ditë kalendarike para datës së mbylljes, me qëllim që Marrëveshja e blerjes në formën e paraqitur për Huadhënësin të jetë në fuqi dhe efekt të plotë (aneksi 6);

b) një opinion të Ministrit të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë të pranueshëm për Huadhënësin me atë përmbajtje që mund të kërkojë Huadhënësi (sipas aneksit 5), së bashku me kopje të vërtetuara të çdo miratimi ose autorizimi të përmendur në këtë opinion;

c) një kopje të vendimit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që miraton në parim këtë Marrëveshje;

d) një prokurë të lëshuar nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë që autorizon një person ose persona të caktuar për të nënshkruar këtë Marrëveshje dhe të gjitha dokumentet dhe njoftimet e tjera që duhet të nënshkruhen dhe/ose shpërndahen në lidhje me këtë Marrëveshje;

e) një origjinal të kësaj Marrëveshjeje të nënshkruar rregullisht nga një person ose persona të autorizuar me prokurën e përmendur në paragrafin (d) më sipër;

f) ekzemplarë firmash të vërtetuara të personit ose personave të autorizuar për të nënshkruar të gjitha dokumentet dhe njoftimet e tjera që duhet t'i jepen Huadhënësit sipas kësaj Marrëveshjeje në emër të Huamarrësit;

g) një emërim të një personi kontakti për Huamarrësin në Republikën e Austrisë për Marrëveshjen (aneksi 7);

h) çdo dokument, provë ose autorizim tjetër që Huadhënësi mund të kërkojë me qëllim që të realizojë këtë Marrëveshje dhe transaksionet e parashikuara sipas kësaj Marrëveshjeje nga një marrëveshje ligjore, të vlefshme, detyruese dhe të zbatueshme.

ii) Huadhënësi do të ketë marrë:

a) garancinë e lëshuar nga OeKB-ja për dhe në emër të Republikës së Austrisë, në përputhje me ligjin e Promovimit të Eksportit të vitit 1981, të ndryshuar, termat dhe kushtet e të cilit mund të përmbushen nga Huadhënësi;

b) Një marrëveshje rifinancimi me OeKB-në për huan;

c) Një marrëveshje plotësuese me eksportuesin e projektit dhe miratimi nga autoritetet e Huadhënësit të kësaj Marrëveshjeje.

iii) Çdo kusht plotësues (nëse ka) të kërkuar në garancinë e Republikës së Austrisë të lëshuar nga OeKB-ja.

Me përmbushjen e të gjitha kushteve të lartpërmendura, Huadhënësi do të njoftojë menjëherë Huamarrësin për këtë qëllim. Nëse këto kushte nuk do të jenë përmbushur brenda periudhës së mbylljes të përcaktuar në aneksin 3 të kësaj Marrëveshjeje, pa cenuar detyrimin e Huamarrësit sipas seksionit 4.2, kjo Marrëveshje do të pushojë së qeni detyruese për palët.

Secili prej dokumenteve dhe njoftimeve të lartpërmendura do të jetë në gjuhën angleze ose gjermane. Nëse nuk është në gjuhën angleze ose gjermane, një përkthim i vërtetuar në gjuhën angleze i bashkëlidhet dokumentit të mësipërm.

8. RASTE TË MOSPLOTËSIMIT TË DETYRIMEVE

8.1 Raste të mosplotësimit të detyrimeve

Secili prej rasteve të mëposhtme përbën një rast të mosplotësimit të detyrimeve:

a) ka një paaftësi paguese për më shumë se 14 (katërmbëdhjetë) ditë kalendarike nga Huamarrësi të ndonjë principali, interesi ose shume tjetër të kërkueshme në lidhje me huan; ose

b) Huamarrësi është i paaftë për të përmbushur ose respektuar siç duhet ndonjë kusht ose sipërmarrje në përmbajtje të kësaj Marrëveshjeje, të ndryshme nga pagesa e principalit, interesit ose shumave të tjera për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike nga data më e hershme në të cilën Huamarrësi vihet në dijeni të paaftësisë dhe data në të cilën njoftimi me shkrim për këtë paaftësi që kërkon nga Huamarrësi për ta kompensuar, do t'i jetë dhënë më parë Huamarrësit nga Huadhënësi; ose

c) çdo garanci ose sipërmarrje të bërë nga Huamarrësi në lidhje me këtë Marrëveshje do të rezultojë të ketë qenë e pasaktë në aspekte materiale në kohën kur është bërë; ose

d) Huamarrësi do të jetë në mosplotësim të pagesës ose përmbushjes së ndonjë detyrimi në lidhje me paratë e marra hua të ndryshme nga huaja (duke përfshirë, në çdo rast një detyrim sipas një garancie); ose

e) çdo licencë, pëlqim, regjistrim ose aprovim (qeveritar apo ndryshe) e kërkuar për vlefshmërinë, zbatueshmërinë ose ligjshmërinë e kësaj Marrëveshjeje ose Huaje, ose realizimi i të cilave është tërhequr ose për ndonjë arsye pushon së qeni në fuqi dhe efekt të plotë; ose

f) Republika e Shqipërisë shpall një moratorium të përgjithshëm për detyrimet e pagesës ndaj kreditorëve të saj; ose

g) çdo ngjarje që ka në diskrecionin e arsyeshëm të Huadhënësit një ndikim të kundërt material në aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje; ose

h) garancia e Republikës së Austrisë e lëshuar nga OeKB-ja ose ndonjë prej dispozitave të saj është revokuar, ka përfunduar ose ka pushuar së qenuri në fuqi dhe efekt ose ka pushuar së dhëni sigurinë e synuar ose bëhet e paligjshme ose shpallet e pavlefshme për arsye, raste ose rrethana që mund t'i atribuohen sferës së Huamarrësit.

8.2 Masat për rastet e mosplotësimit të detyrimeve

Nëse ka ndodhur një rast i mosplotësimit të detyrimeve dhe në çdo kohë më pas do të jetë e vazhdueshme ndonjë ose të gjitha prej masave të mëposhtme që mund të merren nga Huadhënësi:

a) me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Huamarrësit, Huadhënësi mund të shpallë principalin dhe interesin e shtuar në lidhje me huan dhe të gjitha shumat e tjera të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, si menjëherë të kërkueshëm dhe të pagueshëm, pas së cilit do të bëhen menjëherë të kërkueshëm dhe të pagueshëm, pa parashtrim, kërkesë, kundërshtim ose njoftim tjetër të ndonjë lloji;

b) me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Huamarrësit, Huadhënësi mund të shpallë të përfunduar shumën e kredisë, pas së cilës detyrimi i Huadhënësit për të realizuar dhe vazhduar huan sipas kësaj Marrëveshjeje do të përfundojë menjëherë; dhe

c) çdo masë tjetër që Huadhënësi mund të vendosë të marrë në diskrecionin e tij absolut.

Huamarrësi bie dakord t'i paguajë Huadhënësit, sipas kërkesës, të gjitha humbjet, shpenzimet e arsyeshme dhe detyrimet që Huadhënësi mund të pësojë si pasojë e ndonjë mosplotësimi detyrimesh (duke përfshirë, por pa u kufizuar në ndonjë interes të paguar nga Huadhënësi për huadhënësit e fondeve të marra hua nga ai për të ruajtur ndonjë shumë të vonuar). Një vërtetim nga një nëpunës i autorizuar rregullisht i Huadhënësit që përcakton shumën e këtyre humbjeve, shpenzimet e arsyeshme dhe detyrimet dhe bazën e llogaritjes së tyre, kur i paraqiten Huamarrësit (përveç ndonjë gabimi të hapur) do të jenë prova përfundimtare të shumës së këtyre humbjeve, shpenzimeve dhe detyrimeve, me kusht që ky vërtetim të mbështetet nga dokumente që japin të dhëna për këto humbje, shpenzime dhe detyrime dhe këto vërtetime do të mbështeten nga dokumentet e caktuara.

Sapo të vihet në dijeni për këtë, Huamarrësi do t'i japë një njoftim me shkrim Huadhënësit për:

a) çdo rast të mosplotësimit të detyrimeve; ose

b) çdo kusht, ngjarje ose veprim që me dhënien e njoftimit ose kalimin e kohës ose të dyjave, ose përmbushjes së ndonjë kushti mund të çonte në ose përbënte një rast të mosplotësimit të detyrimeve.

9. GARANCITË DHE SIPËRMARRJET

9.1 Garancitë

Me qëllim që të nxitë Huadhënësin për të hyrë në këtë Marrëveshje dhe për të parapaguar dhe mbajtur huan e parashikuar në këtë Marrëveshje, Huamarrësi bën garancitë e mëposhtme në datën e pranimit:

a) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë autorizohet të veprojë në emër të dhe për Republikën e Shqipërisë dhe të vendosë Republikën e Shqipërisë para detyrimit ligjor përkatës. Rrjedhimisht, detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje janë detyrime të pakufizuara dhe të pakushtëzuara të Republikës së Shqipërisë. Republika e Shqipërisë mund të paditet në emër të saj në lidhje me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje;

b) Huamarrësi nuk është në mosplotësim të ndonjë prej detyrimeve të tij të pagesës dhe nuk ka ndodhur dhe nuk po vazhdon asnjë rast i mosplotësimit të detyrimeve; ose

c) Huamarrësi ka autoritetin për të hyrë në këtë Marrëveshje dhe për të marrë hua sipas kësaj Marrëveshjeje dhe për të ekzekutuar, dorëzuar dhe realizuar këtë Marrëveshje dhe ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të autorizuar termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe për të autorizuar ekzekutimin, dorëzimin dhe realizimin e kësaj Marrëveshjeje që përbën një detyrim ligjor, të vlefshëm dhe detyrues të Huamarrësit, të zbatueshëm në përputhje me kushtet e tij; ose

d) ekzekutimi, dorëzimi dhe realizimi i kësaj Marrëveshjeje nuk shkel dispozitat e ndonjë ligji ose rregulloreje të zbatueshme për Huamarrësin ose ndonjë marrëveshje, kontratë ose sipërmarrje tjetër, në të cilën Huamarrësi është palë ose që është detyruese për të ose asetet e tij; ose

e) të gjitha licencat, pëlqimet, regjistrimet ose aprovimet (qeveritare apo ndryshe) të nevojshme në lidhje me ekzekutimin, dorëzimin, realizimin, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje janë marrë ose realizuar dhe janë në fuqi dhe efekt të plotë.

Garancitë e parashtruara më sipër do të vazhdojnë edhe pas ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje dhe konsiderohen të përsëritura në çdo datë të Huamarrjes dhe në çdo datë të pagesës së interesit.

9.2 Sipërmarrjet

Huamarrësi zotohet dhe merr përsipër me dhe për Huadhënësin si më poshtë:

a) Të dhënat:

Huamarrësi do të marrë masa:

1. që: i) blerësi i projektit të mbajë të dhëna të mjaftueshme për të identifikuar mallrat dhe shërbimet e financuara nga huaja; ii) blerësi i projektit informon për përdorimin e tyre në projekt; dhe iii) Blerësi i Projektit regjistron progresin e projektit, duke përfshirë kostot e tij;

2. përfaqësuesit e Huadhënësit duhet të lejohen të inspektojnë projektin, sipërmarrjen e blerësit të projektit, mallrat dhe shërbimet e dhëna sipas Marrëveshjes së blerjes dhe çdo të dhënë dhe dokument tjetër;

3. për t'u informuar ose për t'i dhënë Huadhënësit të gjithë informacionin që Huadhënësi kërkon në lidhje me shpenzimet e huas, projektin dhe mallrat dhe shërbimet e dhëna sipas Marrëveshjes së blerjes.

b) *Pari passu* dhe pengu negativ

Detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje klasifikohen të paktën *pari passu* dhe njëlloj me të gjitha detyrimet e tjera të papaguara të pasiguruara dhe të pavarura të Huamarrësit. Nga data e pranimit dhe për sa kohë që një pjesë e huas mbetet e papaguar, Huamarrësi nuk do të krijojë ose bjerë dakord për të krijuar ndonjë hipotekë, detyrim, peng, të drejtë mbajtjeje ose interes tjetër garancie mbi të gjithë ose një pjesë të aseteve të tij për të siguruar detyrime ose garanci të ndonjë detyrimi, nëse huaja nuk sigurohet në mënyrë të barabartë dhe përpjesëtimore, të pranueshme për Huadhënësin.

c) Amendimi i Marrëveshjes së blerjes

Huamarrësi nuk do të bëjë, lejojë ose miratojë ndonjë amendim, ndryshim, modifikim ose përfundim të Marrëveshjes së blerjes pa miratimin paraprak me shkrim të Huadhënësit.

10. LIGJI RREGULLUES DHE MOSMARRËVESHJET

a) Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligji i Republikës së Austrisë.

b) Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin në lidhje me këtë Marrëveshje, duke përfshirë lidhjen e saj, vlefshmërinë dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve sipas kësaj Marrëveshjeje, zgjidhen përfundimisht nga tre arbitra, sipas Rregullave të Pajtimit dhe Arbitrazhit në atë kohë në fuqi të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris.

c) Vendi i arbitrazhit do të jetë Parisi. Gjuha që duhet të përdoret në procedimet e arbitrazhit do të jetë anglishtja.

d) Vendimi i arbitrazhit përcakton përgjegjësinë e palëve për kostot e shkaktuara nga palët.

e) Arbitrat do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të realizuar procedimet dhe për të përgatitur vendimin e tyre në mënyrë që ta bëjnë vendimin të zbatueshëm sipas ligjit.

f) Gjykimi për vendimin mund të zhvillohet në çdo gjykatë që ka juridiksion ose në atë gjykatë mund të bëhet kërkesë për një pranim gjyqësor të vendimit dhe një urdhër ekzekutimi, sipas rastit.

g) Nëse Huadhënësi merr masa ligjore (duke përfshirë padinë, arbitrazhin, sekuestrimin, ekzekutimin ose ndonjë zbatim tjetër ose masë mbrojtëse) kundër Huamarrësit në lidhje me ndonjë çështje sipas kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi heq dorë kështu nga çdo e drejtë imuniteti që mund të ketë Huamarrësi.

h) Huamarrësi cakton Ambasadën e Republikës së Shqipërisë si personin e saj të kontaktit në Vjenë (aneksi 7).

11. TË PËRGJITHSHME

11.1 Njoftimet

Të gjitha njoftimet, kërkesat dhe komunikimet e tjera do të jenë efektive në rast të një njoftimi me shkrim me letër rekomande kur merret ose në rast të njoftimit me faks, kur merret nga pala për të cilën ky njoftim, kërkesë ose komunikim tjetër kërkohet ose lejohet të jepet ose bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje, drejtuar Huamarrësit ose Huadhënësit përkatësisht në adresat e tyre të përcaktuara në aneksin 1 ose në një adresë tjetër që ndonjë prej tyre mund të përcaktojë më pas me shkrim për tjetrin, në përputhje me këtë seksion 11.1.

11.2 Titujt përshkrues

Titujt në këtë Marrëveshje janë vetëm për lehtësi reference dhe nuk përcaktojnë ose kufizojnë dispozitat e saj.

11.3 Heqjet dorë, mjetet kumulative

Asnjë paaftësi ose vonesë nga ana e Huadhënësit në ushtrimin e ndonjë të drejte, kompetence ose privilegji sipas kësaj Marrëveshjeje dhe asnjë kurs transaksioni ndërmjet

Huamarrësit dhe Huadhënësit nuk do të operojë si heqje dorë nga kjo; as një ushtrim i vetëm ose i pjesshëm i ndonjë të drejte, kompetence ose privilegji sipas kësaj Marrëveshjeje, nuk do të përjashtojë një ushtrim tjetër ose të mëtejshëm të tyre ose ushtrimin e ndonjë të drejte, kompetence ose privilegji tjetër. Të drejtat dhe mjetet ligjore në këtë marrëveshje të parashikuara shprehimisht janë kumulative dhe nuk janë ekskluzive për ndonjë të drejtë ose mjet ligjor që Huadhënësi do të kishte ndryshe. Asnjë njoftim për ose kërkesë ndaj Huamarrësit në çdo rast nuk autorizon Huamarrësin për ndonjë njoftim ose kërkesë tjetër ose të mëtejshme në lidhje me të njëjtat rrethana ose nuk përbën një heqje dorë nga të drejtat e Huadhënësit të ndonjë veprimi tjetër ose të mëtejshëm në lidhje me këto rrethana pa njoftim ose kërkesë.

11.4 Pavlefshmëria e pjesshme

Nëse ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje çmohet nga ndonjë gjykatë ose autoritet tjetër kompetent gjyqësor si e pazbatueshme, vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave të mbetura të saj nuk do të cenohet ose preket në ndonjë mënyrë dhe palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të rishikuar dispozitën e pavlefshme, në mënyrë që ta bëjnë atë të zbatueshme në përputhje me qëllimin e shprehur në të.

11.5 Transferimi

Huamarrësi nuk mund të caktojë ose transferojë të gjithë ose ndonjë pjesë të të drejtave dhe detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje, pa miratimin paraprak me shkrim të Huadhënësit.

Huadhënësi mund të caktojë të drejtat dhe detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje: i) pa miratimin e Huamarrësit, nëse drejtëmarrësi është OeKB-ja ose (në rastin vetëm të mosplotësimit të detyrimeve) çdo bankë ose institucion tjetër financiar, dhe ii) me miratimin paraprak me shkrim të Huamarrësit që nuk do të pengohet në mënyrë të paarsyeshme ndonjë drejtëmarrës tjetër.

11.6 Fshehtësia

Me anë të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi bie dakord që Huadhënësi të ketë të drejtën për të paraqitur në një mënyrë që është e zakonshme nga bankat, të gjithë informacionin që ai merr në lidhje me këtë Marrëveshje ose marrëdhënien e tij të punës me Huamarrësin, veçanërisht në interes të një mbrojtjeje të arsyeshme të kreditorëve për bankat, institucionet e përbashkëta të bankave ose organizatat e përzgjedhura për mbrojtjen e kreditorëve.

Me anë të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi bie dakord më tej që Huadhënësi të ketë të drejtën për të dhënë informacion që rezulton nga kjo Marrëveshje ose marrëdhënia e punës së Huadhënësit me Huamarrësin për personat ose subjektet e mëposhtme:

a) çdo anëtar të grupit të subjekteve të Huadhënësit;

b) një drejtëmarrës i mundshëm ose për çdo person ose subjekt tjetër që mund të propozojë hyrjen në marrëdhënie kontraktuale me Huadhënësin në lidhje me këtë Marrëveshje;

c) OeKB-ja dhe Republika e Austrisë; dhe

d) çdo person, autoritet ose subjekt tjetër të cilit Huadhënësit i kërkohet të japë këtë informacion sipas ndonjë ligji ose urdhri gjykate ose autoriteti tjetër gjyqësor ose organi rregullator me udhëzimet e të cilit duhet të pajtohet Huadhënësi.

11.7 Amendimet e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje nuk mund të ndryshohet ose amendohet përveçse me instrumente me shkrim.

12. HYRJA NË FUQI

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi me nënshkrimin nga palët dhe ratifikimin nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe botimin në Fletoren Zyrtare Shqiptare.

Në dëshmi të kësaj, palët kanë ekzekutuar këtë Marrëveshje në datën e shkruar më parë, më sipër në dy kopje origjinale në gjuhën angleze dhe versioni në gjuhën angleze do të jetë detyrues dhe do të ketë përparësi mbi përkthimet.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë si Huamarrësi (i përfaqësuar nga Ministria e Financave)	UniCredit Bank Austria AG si Huadhënësi

ANEKSI 1

PALËT

HUAMARRËSI

Emri: Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë
që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë si Huamarrës
(përfaqësuar nga Ministria e Financave)

Adresa:
Ministria e Financave
Bul.: "Dëshmorët e Kombit", nr.1
Tirana, Albania
Telefon: (355 4) 222 84 05
Faks: (355 4) 222 84 94

HUADHËNËSI
Emri: UniCredit Bank Austria AG
Adresa: Schottengasee 6-8, A-1010 Vienna
Telefon: +43 (0)5 05 05-56326
Faks: +43 (0)5 05 05-56934
Departamenti përgjegjës: 8243 Export Finance
z. Gerd Rose

ANEKSI 2

1. Projekti
Përmirësimi i pajisjeve mjekësore për 6 spitale rajonale në Shqipëri
2. Marrëveshja e blerjes:
Marrëveshja nr.ALB 2010-001 e datës …… ndërmjet Philips Medizinische Systeme Gesellschaft m.b.H., Vjenë (eksportuesi i projektit) dhe Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Shqipërisë (blerësi i projektit) për shumën prej 5 958 000 euro (pesë milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë mijë euro) në lidhje me projektin.

ANEKSI 3

1. Llogaria e kredisë (paragrafi 2.2)
Një shumë që nuk i kalon 5 958 000 euro (pesë milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë mijë euro).
2. Periudha e disponueshmërisë (paragrafi 2.2)
Nga data e mbylljes (siç përcaktohet në paragrafin 7) deri në ditën që përkon me 9 muaj pas saj/datës së mbylljes.
3. Interesi (paragrafi 3.1)
0 % në vit.
4. Kamatëvonesa (paragrafi 3.3)
3 muaj EURIBOR plus një marzh prej 2% në vit.
5. Tarifa e angazhimit (paragrafi 4.1)
0.5 % në vit (zero pikë pesë për qind në vit).
6. Tarifa e drejtimit (paragrafi 4.2)
0.5 (zero pikë pesë për qind) e pandryshuar ndaj kredisë.
7. Primi i garancisë (paragrafi 4.3)

i) Primi i garancisë së OeKB-së paraprakisht i pagueshëm.

16 127,53 euro (vetëm e dhënë).

Shuma përfundimtare do të përcaktohet nga OeKB-ja pas lëshimit të garancisë fillestare. Në rast se shuma përfundimtare ndryshon nga ajo e shpallur/treguar, Huamarrësi do të shlyejë diferencën (nëse ekziston) brenda 30 ditëve kalendarike pasi të jetë njoftuar mbi ndryshimin nga ana e Huadhënësit.

ii) Primi i garancisë së OeKB-së i pagueshëm si marzh.

1.054 për qind në vit.

Sipas OeKB-së norma e mësipërme mbështetet nga një grant shtesë që arrin afërsisht 280 264,32 euro nga Ministria Federale e Financave e Austrisë. Norma dhe granti përfundimtar, nëse ekziston, do të përcaktohet nga OeKB-ja pas lëshimit të garancisë fillestare.

8. Tarifa e trajtimit e OeKB-së

1 440 euro në lidhje me sigurimin e kredisë së eksportit.

9. Datat e detyrueshme të shlyerjes (paragrafi 5.1)

Shlyerja do të realizohet deri në 17 këste të barabarta 6-mujore të njëpasnjëshme; i pari duhet të paguhet 48 muaj pas datës së përkohshme të pranimit, në çdo rast jo më vonë se 57 muaj pas datës së mbylljes.

10. Shuma opsionale e parapagimit (paragrafi 5.2)

500 000 euro.

11. Periudha e përfundimit (paragrafi 7)

Periudha që fillon në datën e pranimit deri maksimumi 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike pas datës së pranimit.

ANEKSI 4
PROCEDURAT E PAGESËS

Huamarrësi në këtë mënyrë autorizon në mënyrë të pakthyeshme Huadhënësin të paguajë eksportuesin e projektit deri në maksimumin e shumës së kredisë të përmendur në aneksin 3 kundrejt paraqitjes së dokumenteve të mëposhtme për llogari të Huadhënësit:

Paradhënia:

15% (pesëmbëdhjetë për qind) e shumës së Marrëveshjes së blerjes, e cila është 893 700 euro (me fjalë: tetëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e shtatëqind) janë të pagueshme si paradhënie, pas paraqitjes së:

- faturës së paradhënies ose faturës tregtare të eksportuesit të projektit në 3 (tre) origjinale dhe 7 (shtatë) kopje.
- kopje të obligacionit të performancës të lëshuara nga një bankë austriake në shumën prej 5% të Marrëveshjes së blerjes.
- kopje të garancisë së paradhënies të lëshuar nga një bankë austriake në shumën prej 5% të Marrëveshjes së blerjes.

Pagesa kundrejt dërgesës

80% (tetëdhjetë për qind) të shumës së Marrëveshjes së blerjes, e cila është 4 766 400 euro (me fjalë: katër milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind) janë të pagueshme me paraqitjen e dokumenteve të mëposhtme:

- fatura tregtare e eksportuesit të projektit në 3 (tre) origjinale, të gjitha të firmosura, sipas rregullave nga eksportuesi i projektit, dhe 7 (shtatë) kopje.
- certifikata e sigurimit në 1 (një) origjinal dhe 3 (tre) kopje.
- lista e paketimeve në 1 (një) origjinal dhe 7 (shtatë) kopje.
- (CMR) në 1 (një) origjinal dhe 7 (shtatë) kopje të dorëzuara pranë Ministrisë së Shëndetësisë, bulevardi “Bajram Curri”, nr.1, Tiranë, Republika e Shqipërisë, duke përcaktuar palën njoftuese: Ministria e Shëndetësisë, bulevardi “Bajram Curri” nr.1, Tiranë, Republika e Shqipërisë, duke deklaruar destinacionin në Shqipëri, ngarkesën e parapaguar dhe numrin e kontratës ALB 2010-001 ……

ose

- Fatura e transportit ajror në 1 (një) origjinal dhe 7 (shtatë) kopje, të dorëzuara pranë Ministrisë së Shëndetësisë, bulevardi "Bajram Curri", nr.1, Tirana, Republika e Shqipërisë, duke përcaktuar palën njoftuese, Ministria e Shëndetësisë, bulevardi "Bajram Curri" nr.1, Tiranë, Republika e Shqipërisë, duke deklaruar destinacionin aeroportin e destinacionit në Shqipëri, ngarkesën e parapaguar dhe me numrin e kontratës ALB 2010-001.

Pagesa kundrejt certifikatës së pranimit (COHO)

5% (pesë për qind) e shumës së kontratës së blerjes, e cila është 297 900 euro (me fjalë: dyqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind) janë të pagueshme kundrejt paraqitjes së:

- faturës tregtare të eksportuesit të projektit në 3 (tre) origjinale dhe 7 (shtatë) kopje; dhe
- shtatë (7) kopje të aprovimit të certifikatës së pranimit (COHO-s) përkatëse.

Huadhënësit i jepet e drejta të bazohet në çdo dokument, të cilin e gjykojnë si të vërtetë dhe të saktë dhe që është nënshkruar ose dërguar nga personi i duhur. Huadhënësi nuk mban përgjegjësi apo detyrime për formën, mjaftueshmërinë, saktësinë, vërtetësinë, falsifikimin apo fuqinë ligjore të secilit dokument/e ose për kushtet e përgjithshme dhe/ose të veçanta të parashikuara në dokument/e apo të mbivendosura mbi to; as merr përsipër detyrime ose përgjegjësi për përshkrimin, sasinë, peshën, cilësinë, kushtet, paketimin, shpërndarjen, vlerën apo ekzistencën e mallrave ose shërbimeve të përfaqësuara nga secili dokument/e, ose për mirëbesimin apo veprimet dhe/ose mosveprimet, aftësinë paguese, performancën apo qëndrimin e dërguesve të mallrave, transportuesve, marrësve të ngarkesës, apo siguruesve të mallrave ose të çdo personi tjetër kushdo qoftë.

Janë të lejuara dërgesa të pjesshme dhe paraqitje të pjesshme të dokumenteve.

Huadhënësi do t'i japë Huamarrësit një njoftim me shkrim pas realizimit të një huamarrjeje për eksportuesin e projektit.

Pasi një huamarrje të jetë realizuar për eksportuesin e projektit, Huadhënësi do t'i ridërgojë dokumentacionin përkatës Huamarrësit, në…… , adresën ……. me anë të një shërbimi të veçantë korrier.

ANEKSI 5
OPINIONI LIGJOR

(Model)

Nga: Ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë

Drejtuar: UniCredit Bank Austria AG

Datë:……

Unë, ……, duke vepruar në cilësinë e Ministrit të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë, i referohem marrëveshjes së eksportit të kredisë për një hua të butë nr.230.247 për shumën prej 5 958 000 euro (Marrëveshja) datë ……. 2010 dhe autorizoj Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë të veprojë në emër të Republikës së Shqipërisë si Huamarrës (përfaqësuar nga Ministri i Financave) (Huamarrësi) dhe UniCredit Bank Austria AG si huadhënës (Huadhënësi). Nuk shpreh mendim në lidhje me ligjet e ndonjë juridiksioni të ndryshëm nga ai i Republikës së Shqipërisë.

Kam kontrolluar kopjen e nënshkruar dhe përfunduar të Marrëveshjes dhe dokumente të tjera që i kam gjykuar të nevojshme dhe të përshtatshme, me qëllim që të mund të paraqes mendimin në fjalë. Afatet e përcaktuara në Marrëveshje mbartin të njëjtin kuptim, përveçse kur Marrëveshja përcakton ndryshe.

Bazuar në sa më sipër, jam i mendimit se:

a) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë autorizohet të veprojë në emër të dhe për Republikën e Shqipërisë dhe të detyrojë ligjërisht Republikën e Shqipërisë. Për pasojë, detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje janë detyrime të pakufizuara dhe të pakushtëzuara të Republikës së Shqipërisë. Ndaj Republikës së Shqipërisë mund të ngrihet padi në emrin e saj për sa i përket detyrimeve të Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

b) Ministria e Financave autorizohet të veprojë në emër të Huamarrësit dhe të detyrojë ligjërisht Huamarrësin. Për pasojë, të gjitha detyrimet, sipas kësaj Marrëveshjeje janë detyrime të vlefshme, ligjërisht detyruese dhe të zbatueshme të Huamarrësit. Huamarrësi ka autoritet të ngrejë padi apo t'i ngrihet padi në emrin e tij.

c) Huamarrësi gëzon autoritetin të hyjë në/nënshkruajë dhe realizojë Marrëveshjen. Huamarrësi ka marrë të gjitha masat e nevojshme (qeveritare dhe ndryshe) për të autorizuar nënshkrimin e Marrëveshjes sipas termave dhe kushteve që ajo parashikon dhe ekzekutimin, dorëzimin dhe përmbushjen e Marrëveshjes.

d) Marrëveshja është nënshkruar nga z. …… në cilësinë e Ministrit të Financave të Republikës së Shqipërisë.

e) Marrëveshja e nënshkruar nga Ministri i Financave në emër të Huamarrësit cakton detyrime ligjore, të vlefshme dhe detyruese për Huamarrësin, të zbatueshme në gjykatat e Republikës së Shqipërisë në përputhje me afatet e saj.

f) Personi ose personat që nënshkruajnë Marrëveshjen, që nënshkruajnë apo vërtetojnë çdo dokument tjetër në lidhje me Marrëveshjen kanë fuqi dhe autoritet të plotë për të vepruar në këtë mënyrë në emër të Huamarrësit.

g) Ekzekutimi dhe realizimi i Marrëveshjes dhe transaksionet e parashikuara prej saj nuk cenojnë: i) ligjet, rregulloret ose urdhrat zyrtare apo gjyqësore; ii) traktatet, marrëveshjet ose dokumente apo instrumente të tjera, në të cilat Huamarrësi dhe/ose Republika e Shqipërisë është palë ose që kanë efekt detyrues mbi të apo mbi asetet përkatëse të saj.

h) Të gjitha autorizimet, aprovimet (përfshirë, nëse është e nevojshme, aprovimet e shkëmbimeve të kontrollit), pëlqimet, lejet, përjashtimet, të dhënat, regjistrimet, noterizimet dhe kërkesat e tjera të autoriteteve dhe institucioneve qeveritare, gjyqësore dhe publike të nevojshme ose të rekomandueshme në lidhje me ekzekutimin, zbatimin, vlefshmërinë dhe realizimin e Marrëveshjes apo çdo pagese të realizuar sipas saj, janë nxjerrë dhe janë në fuqi dhe efekt të plotë dhe Huamarrësi gëzon autoritetin e plotë për të kryer të gjitha pagesat sipas Marrëveshjes në euro.

i) Të gjitha shumat për t'u paguar nga Huamarrësi sipas Marrëveshjes mund të realizohen të plota dhe pa zbritje për ose për sa i përket çdo tarife, takse, zbritje apo detyrimi nga ana e Republikës së Shqipërisë, çdo autoriteti tatimor apo të nënndarjes politike. Në rast të ndonjë ndalimi/zbritjeje për sa i përket pagesave të interesit sipas Marrëveshjes, detyrimi i Huamarrësit për të paguar shuma shtesë sipas paragrafit 6.4 mbetet i vlefshëm dhe i zbatueshëm.

j) Kjo Marrëveshje është ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe botuar në Fletoren Zyrtare Shqiptare dhe nuk është e nevojshme apo e këshillueshme që të sigurohet ligjshmëria, vlefshmëria, zbatueshmëria apo pranueshmëria si dëshmi të Marrëveshjes në mënyrë që ajo të arkivohet apo regjistrohet pranë ndonjë autoriteti tjetër qeveritar apo agjenci në Republikën e Shqipërisë.

k) Përzgjedhja e ligjit të Republikës së Austrisë për të rregulluar Marrëveshjen është një zgjidhje e vlefshme ligjore dhe njihet dhe zbatohet në çdo gjykatë të Republikës së Shqipërisë.

Huamarrësi i nënshtrohet ligjit civil për sa u përket detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje. Lidhja dhe realizimi i Marrëveshjes nga ana e Huamarrësit përbën akte private dhe tregtare. Heqja dorë nga imuniteti në paragrafin 10 (g) të Marrëveshjes është e vlefshme dhe detyruese për Huamarrësin.

l) Nuk është e nevojshme sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë: i) me qëllim mundësimin e Huadhënësit për të zbatuar të drejtat e tij sipas Marrëveshjes, ose ii) për shkak të ekzekutimit, dorëzimit, realizimit ose zbatimit të Marrëveshjes, që Huadhënësi të licencohet, kualifikohet apo t'i jepet e drejta për të realizuar marrëdhënie tregtare në Republikën e Shqipërisë.

Huadhënësi as është, as do të jetë rezident, me banim të përhershëm, të realizojë marrëdhënie tregtare apo t'i nënshtrohet tatimit në Republikën e Shqipërisë për shkak vetëm të ekzekutimit, dorëzimit, realizimit ose zbatimit të Marrëveshjes.

m) Dispozitat e paragrafit 10 të Marrëveshjes janë të ligjshme, të vlefshme dhe detyruese sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Gjykatat e Republikës së Shqipërisë do të njohin çdo vendim dhe/ose gjykim arbitrazhi në lidhje me Marrëveshjen si të vlefshëm dhe përfundimtar dhe do të zbatojnë vendime gjyqësore dhe/ose këto gjykime arbitrazhi.

Një vendim i emërtuar në EURO (euro) do të njihet dhe zbatohet në Republikën e Shqipërisë.

Sipas informacionit që zotëroj, nuk ekziston asnjë çështje gjyqësore, arbitrazhi apo çështje administrative aktuale apo e mbetur pezull ndaj Huamarrësit, e cila do të ose mund të rezultonte në një ndryshim të kundërt material në kushtet financiare apo të përbashkëta të Huamarrësit.

n) Marrëveshja dhe i gjithë dokumentacioni tjetër nuk përmban ndonjë dispozitë, e cila duhet të mbetet e pazbatueshme sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë.

o) Detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes në çdo rast do të renditen *pari passu* me të gjitha detyrimet e tjera të Huamarrësit, përveç detyrimeve të parashikuara si të detyrueshme me ligj.

Ky opinion ligjor paraqitet për përfitimin e vetëm të Huadhënësit dhe mund të mos i bëhet i njohur një personi tjetër.

Me respekt

ANEKSI 6
KONFIRMIMI SE MARRËVESHJA E BLERJES MBETET NË FUQI DHE EFEKT TË PLOTË

{Huadhënësi}

Lënda: Marrëveshja e eksportit të kredisë për një hua të butë nr.230.247 për shumën prej 5 958 000 euro (Marrëveshja) datë……. 2010 dhe ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë si Huamarrës (përfaqësuar nga Ministri i Financave) (Huamarrësi) dhe UniCredit Bank Austria AG si huadhënës (Huadhënësi).

Të nderuar zotërinj,

Me anë të kësaj, ju konfirmojmë se Marrëveshja e blerjes {nr. …} lidhur më {……} ndërmjet {……} dhe {……} ka hyrë në fuqi më {……}.

Vjenë, ……

……

{Eksportuesi i projektit}

ANEKSI 7
PRANIMI I EMËRIMIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT

{Huadhënësi}

Lënda: Marrëveshja e eksportit të kredisë për një hua të butë nr.230.247 për shumën prej 5 958 000 euro (Marrëveshja) datë……. 2010 dhe ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë si Huamarrës (përfaqësuar nga Ministri i Financave) (Huamarrësi) dhe UniCredit Bank Austria AG si huadhënës (Huadhënësi).

Të nderuar zotërinj,

Si ambasador i Republikës së Shqipërisë në Vjenë, Republika e Austrisë, pranoj, në emrin tim dhe në emër të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, emërimin si person të autorizuar të Huamarrësit për të shërbyer si person kontakti për kredinë e eksportit.

Adresa ime në Vjenë: ……

Në rast të ndryshimit të adresës, do t'ju njoftoj me shkrim pa vonesë.

Me respekt

……

Ambasada e
Republikës së Shqipërisë në Austri
Vendi, data ……

LIGJ
Nr.10 332, datë 14.10.2010

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE EUROPIANE "PËR PROGRAMIN NDËRKUFITAR NDËRMJET SHQIPËRISË DHE GREQISË, PËR VITIN 2009, TË KOMPONENTIT TË DYTË TË INSTRUMENTIT TË NDIHMËS SË PARAADERIMIT (IPA) - BASHKËPUNIMI NDËRKUFITAR PËR SHQIPËRINË""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane "Për programin ndërkufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë, për vitin 2009, të komponentit të dytë të Instrumentit të Ndihmës së Paraaderimit (IPA) - Bashkëpunimi ndërkufitar për Shqipërinë"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6738, datë 21.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE FINANCIMI
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE EUROPIANE MBI PROGRAMIN E BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR NDËRMJET GREQISË DHE SHQIPËRISË PËR VITIN 2009, NËN INSTRUMENTIN E ASISTENCËS SË PARAADERIMIT (IPA) KOMPONENTI II - BASHKËPUNIMI NDËRKUFITAR
(Menaxhim i centralizuaar)

Marrëveshje financimi ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane, këtej e tutje referuar bashkërisht si "Palët" ose individualisht si "Vendi përfitues" në rastin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, ose "Komisioni", në rastin e Komisionit të Komuniteteve Europiane,

Duke pasur parasysh se:

a) Më 1 gusht 2006, Këshilli i Bashkimit Europian vendosi me anë të rregullores (EC) nr.1085/2006, krijimin e një instrumenti të asistencës për paraaderimin (këtej e tutje "Rregullorja kuadër IPA"). Me efekt nga 1 janari 2007, ky instrument përfaqëson bazën e vetme ligjore për dhënien e asistencës financiare për vendet kandidate (aktualisht Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Turqia) dhe kandidate potenciale (Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia, duke përfshirë dhe Kosovën sipas rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244) në përpjekjet e tyre për të forcuar reformat politike, ekonomike dhe institucionale me perspektivën për t'u bërë një ditë anëtare të Bashkimit Europian.

b) Më 12 qershor 2007, Komisioni vendosi me anë të rregullores (EC) nr.718/2007 implementimin e rregullores kuadër IPA, e cila detajon rregullat e aplikueshme të menaxhimit dhe të kontrollit (këtej e tutje "Rregullorja e zbatimit IPA").

c) Asistenca komunitare nën instrumentin e asistencës për paraaderim duhet të vazhdojë të mbështesë vendet përfituese në përpjekjet e tyre për të forcuar institucionet demokratike dhe shtetin e së drejtës, të reformojë administratën publike, të ndërmarrë reforma ekonomike, të respektojë të drejtat e njeriut dhe ato të minoriteteve, të promovojë barazinë gjinore, të mbështesë zhvillimin e shoqërisë civile dhe të çojë përpara bashkëpunimin rajonal, si dhe ripajtimin dhe rindërtimin, dhe të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe reduktimin e varfërisë.

Për vendet potenciale kandidate, asistenca komunitare mund të përfshijë përafrimin me *acquis communautaire*, si dhe mbështetjen për projekte në investime që kanë për qëllim në veçanti ndërtimin e kapaciteteve menaxhuese në fushat e zhvillimit rajonal, të burimeve njerëzore dhe atë rural.

d) Palët kanë nënshkruar më 18 tetor 2007 një marrëveshje kuadër që përcakton rregullat e përgjithshme për bashkëpunim dhe implementimin e asistencës komunitare nën Instrumentin e Paraaderimit.

e) Programi shumëvjeçar i bashkëpunimit ndërkufitar Greqi-Shqipëri 2007-2009, u aprovua me anë të vendimit të Komisionit C(2008) 1069 më 19 mars 2008 dhe u ndryshua me anë të vendimit të Komisionit C(2008) 7342 më 28 nëntor 2008. Për zbatimin e tij në vitin 2009, Komisioni aprovoi më datë 24 gusht 2009 vendimin e financimit C(2009) 6493 për programin ndërkufitar Greqi-Shqipëri (këtej e tutje “Programi”). Pjesa e programit për Shqipërinë do të implementohet nga Komisioni në mënyrë të centralizuar.

f) Për implementimin e këtij programi është e nevojshme që palët të nënshkruajnë një marrëveshje financimi për të përcaktuar kushtet për dhënien e asistencës komunitare, rregullat dhe procedurat që lidhen me disbursimin e kësaj asistence dhe kushteve sipas të cilave do të menaxhohet kjo asistencë.

Kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

1. PROGRAMI

Komisioni do të kontribuojë me anë të një granti për financimin e programit në vijim, i cili është përcaktuar në shtojcën A të kësaj Marrëveshjeje.

Numri i programit: 2009/021-154 (CRIS)

Titulli: Programi ndërkufitar Greqi-Shqipëri nën komponentin e bashkëpunimit ndërkufitar IPA për vitin 2009.

2. ZBATIMI I PROGRAMIT

1. Programi ndërkufitar Greqi-Shqipëri do të zbatohet në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenin 99 (procedura të ndërmjetme) të rregullores së zbatimit IPA.

2. Pjesa e programit për Shqipërinë do të zbatohet nga Komisioni në një mënyrë të centralizuar, sipas nenit 53a të rregullores së Këshillit (EC Euratom) nr.1605/2002 mbi rregulloren financiare të aplikueshme për buxhetin e përgjithshëm të Komuniteteve, të ndryshuar sipas rregullores (EC, Euratom) 1995/2006 të 13 dhjetorit 2006 (këtej e tutje "Rregullorja financiare").

3. Programi do të zbatohet në përputhje me rregullat e Marrëveshjes financiare në rregullat për bashkëpunimin që lidhen me asistencën financiare të BE-së për Shqipërinë dhe zbatimin e asistencës në kuadër të Instrumentit të Paraaderimit (IPA), të arritur ndërmjet Palëve më 18 tetor 2007 (këtej e tutje “Marrëveshja kuadër”), e cila është përcaktuar në aneksin B të kësaj Marrëveshjeje.

3. STRUKTURAT DHE AUTORITETET PËRGJEGJËSE

1. Përfituesi do të caktojë një koordinator kombëtar IPA në përputhje me Marrëveshjen kuadër, i cili do të veprojë si përfaqësuesi i përfituesit përballë Komisionit. Ai duhet të sigurojë që ekziston një lidhje e fortë ndërmjet Komisionit dhe Përfituesit, si për procesin e përgjithshëm të aderimit, ashtu edhe për asistencën e BE-së së paraaderimit nën instrumentin IPA.

2. Koordinatori kombëtar IPA do të jetë, gjithashtu, përgjegjës për koordinimin e pjesëmarrjes së vendit përfitues në programet përkatëse ndërkufitare, si dhe në programet transnacionale, ndërrajonale ose në programet që përfshijnë vende që lagen nga dete, nën instrumente të tjera të Komunitetit.

3. Vendi përfitues duhet të ngrejë një strukturë operuese për pjesën e programit në territorin e vet. Funksionet dhe përgjegjësitë e saj janë përcaktuar në programin ndërkufitar, me përjashtim të tenderimit, kontraktimit dhe pagesave, të cilat janë përgjegjësi e Komisionit.

4. Struktura operuese duhet të bashkëpunojë ngushtë gjatë implementimit të këtij programi me autoritetin menaxhues të vendosur në Greqi.

4. FINANCIMI

Financimi për implementimin e kësaj Marrëveshjeje do të jetë si më poshtë:

a) Kontributi i Komunitetit për vitin 2009 është përcaktuar në një maksimum prej € 1 626 968 për pjesën e programit për Shqipërinë, siç detajohet në shtojcën A1 të aneksit A të kësaj Marrëveshjeje. Megjithatë, pagesa e kontributit të Komunitetit nga Komisioni do të bëhet brenda limiteve të fondeve në dispozicion.

b) Kostoja e strukturave dhe autoriteteve të ngritura nga vendi përfitues për implementimin e programit do të mbulohen nga përfituesi, me përjashtim të kostove referuar në nenin 94(1)(f) të rregullores së zbatimit IPA, siç detajohet në aneksin A.

5. AFATI PËRFUNDIMTAR PËR NËNSHKRIMIN E KONTRATAVE

1. Kontratat dhe marrëveshjet individuale, të cilat zbatojnë këtë Marrëveshje do të nënshkruhen jo më vonë se dy vjet nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Në raste të justifikuara siç duhet, ky afat kontraktimi mund të zgjatet përpara datës së përfundimit të tij për një periudhë maksimale prej tre vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

3. Çdo financim, për të cilin nuk është nënshkruar një kontratë përpara afatit për përfundimin e tij, do të anulohet.

6. AFATI PËR EKZEKUTIMIN E KONTRATAVE

1. Kontratat duhet të zbatohen maksimumi brenda dy vjetësh që nga data e nënshkrimit të tyre.

2. Në raste të justifikuara siç duhet, afati përfundimtar i zbatimit të kontratave mund të shtyhet përpara datës së përfundimit të tyre.

7. AFATI I DISBURSIMIT

1. Disbursimi i fondeve duhet të bëhet jo më vonë se një vit nga data përfundimtare e ekzekutimit të kontratave.

2. Në raste të justifikuara siç duhet, afati për disbursimin e fondeve mund të shtyhet përpara datës së përfundimit të saj.

8. TRAJTIMI I TË ARDHURAVE

1. Të ardhurat, në kuadër të IPA-së, përfshijnë të ardhurat e fituara nga një aktivitet gjatë periudhës së bashkëfinancimit IPA, duke filluar që nga shitjet, qiratë, shërbimet/taksat ose të ardhura të tjera ekuivalente me përjashtim të:

a) të ardhurave të nxjerra gjatë jetës ekonomike të investimeve të bashkëfinancuara në rastin e investimeve në firma;

b) të ardhurave të nxjerra brenda kuadrit të një mase inxhinierie financiare, duke përfshirë kapitalin e një sipërmarrjeje dhe fondet hua, fondet e garancisë, kreditë;

c) aty ku është e aplikueshme, kontributeve nga sektori privat për bashkëfinancimin e aktiviteteve, të cilat do të paraqiten së bashku me kontributin publik në tabelat financiare të programit.

2. Të ardhurat siç përkufizohet në paragrafin 1 më lart, paraqesin të ardhura, të cilat duhet të zbriten nga shuma e shpenzimeve të lejueshme për aktivitetin në fjalë. Jo më vonë se mbyllja e programit këto fatura duhet të zbriten nga shpenzimet e lejueshme relevante për aktivitetin në shumën e tyre të plotë ose proporcionale, në varësi të asaj nëse burojnë plotësisht ose pjesërisht nga

aktiviteti i bashkëfinancuar.

9. SHPENZIMET E LEJUESHME

1. Shpenzimi në kuadër të këtij programi do të jetë i lejueshëm për kontributin e Komunitetit, nëse ai është kryer aktualisht pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Shpenzimet e mëposhtme nuk do të jenë të lejueshme për kontributin e Komunitetit në kuadër të programit në aneksin A:

a) taksat, duke përfshirë taksën mbi vlerën e shtuar (TVSH);

b) detyrimet doganore dhe të importit, ose çdo detyrim tjetër;

c) blerjet, dhëniet me qira ose me kredi të truallit dhe godinave ekzistuese;

d) gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet për proceset gjyqësore;

e) kostot operacionale;

f) pajisje të dorës së dytë;

g) detyrime bankare, kostot për vënie garancie dhe detyrime të ngjashme;

h) kostot për shkëmbime, detyrime dhe humbje nga këmbimi i monedhave të lidhura me ndonjë komponent specifik të llogarive bankare në euro, si dhe shpenzime të tjera financiare;

i) kontribute në natyrë;

j) interesa mbi borxhe.

3. Me shmangie nga paragrafi 2 më lart, shpenzimet e mëposhtme do të jenë të lejueshme:

a) Taksat mbi vlerën e shtuar, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

i) nuk janë të rikthyeshme në asnjë lloj mënyre,

ii) është përcaktuar që ato janë kryer nga përfituesi përfundimtar, dhe

iii) janë të identifikuara qartë në projektpropozim.

b) Detyrimet për transaksione financiare transnacionale.

c) Në rast se zbatimi i një aksioni kërkon që të hapet një ose më shumë llogari të veçanta, detyrimet bankare për hapjen dhe administrimin e llogarive.

d) Kostot për konsulencë ligjore, kostot noteriale, kostot për ekspertë teknikë ose financiarë, dhe kostot financiare dhe të auditimit, nëse ato janë të lidhura direkt me aksionin e bashkëfinancuar dhe janë të nevojshme për përgatitjen ose zbatimin e tij.

e) Kostot e garancisë, të siguruara nga një bankë ose institucione të tjera financiare, në rastet kur një gjë e tillë kërkohet nga legjislacioni kombëtar ose ai i Komunitetit.

f) Shpenzime të përgjithshme të vërtetuara, që janë të bazuara në kosto reale të kërkuara gjatë zbatimit të aktivitetit respektiv. Normat bazë, të llogaritura mbi bazën e kostove mesatare nuk mund të kalojnë 25% të atyre kostove direkte të një aktiviteti, i cili mund të ndikojë nivelin e shpenzimeve të përgjithshme. Përllogaritja duhet të dokumentohet plotësisht dhe të rishikohet periodikisht.

g) Blerja e truallit me një shumë prej deri në 10% të shpenzimeve të lejueshme të aktivitetit respektiv.

4. Përveç asistencës teknike për programin referuar nenit 94 të rregullores së zbatimit IPA, shpenzimet e mëposhtme të paguara nga autoritete publike gjatë përgatitjes dhe implementimit të një aktiviteti do të jenë të lejueshme:

a) kostot e shërbimeve të specializuara të ofruara nga një autoritet publik që është i ndryshëm nga përfituesi final gjatë përgatitjes ose implementimit të një aktiviteti.

b) kostot për sigurimin e shërbimeve që lidhen me përgatitjen dhe implementimin e një aktiviteti të ofruar nga një autoritetet publik, i cili është vetë përfituesi i fundit që kryen një aktivitet për llogari të tij, pa kërkuar ofrues shërbimesh të tjerë, nëse ato janë kosto shtesë dhe lidhen ose me shpenzime të paguara aktualisht, ose direkt për aktivitetin e bashkëfinancuar.

Autoritetet publike respektive duhet ose t'ia ngarkojnë kostot e referuara në pikën (a) të këtij paragrafi përfituesve të fundit ose t'i certifikojnë këto kosto në bazë të dokumenteve që dëshmojnë se kanë të njëjtën vlerë, të cilat bëjnë të mundur identifikimin e kostove reale, të paguara nga ai autoritet për atë aktivitet.

Kostot e referuara në pikën (b) të këtij paragrafi, duhet të jenë të certifikuara me anë të dokumenteve, të cilat bëjnë të mundur identifikimin e kostove reale, të paguara nga autoriteti publik respektiv për atë aksion.

5. Duke respektuar rregullat në paragrafët 1 dhe 4, rregulla të mëtejshme mbi shpenzimet e lejueshme mund të përcaktohen në programin ndërkufitar në aneksin A të kësaj Marrëveshjeje.

10. RUAJTJA E DOKUMENTEVE

1. Të gjitha dokumentet që lidhen me programin në aneksin A, duhet të ruhen të paktën për pesë vjet që nga data në të cilën Parlamenti Europian mbyll vitin buxhetor, të cilit i përket dokumenti.

2. Në rast se programi në aneksin A nuk është mbyllur përfundimisht brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 1 më lart, dokumentet e lidhura me të duhet të mbahen deri në fund të vitit, i cili pason vitin në të cilin programi në aneksin A është mbyllur.

11. PLANI PËR DECENTRALIZIMIN PA KONTROLLE *EX-ANTE*

1. Vendi përfitues duhet të përcaktojë një plan të detajuar me etapa indikative dhe limite kohore për të arritur decentralizimin me kontrolle *ex-ante* nga Komisioni. Përveç kësaj, vendi përfitues duhet të hartojë një plan indikativ për të arritur decentralizimin pa kontrolle *ex-ante* nga Komisioni.

2. Komisioni duhet të monitorojë zbatimin e planeve të përmendura në paragrafin 1 dhe të marrë parasysh rezultatet e arritura nga vendi përfitues në këtë kontekst, në veçanti në sigurimin e asistencës. Plani për të arritur decentralizimin pa kontrolle *ex-ante* mund t'i referohet heqjes dorë gradualisht nga tipat e ndryshëm të kontrolleve *ex-ante*.

3. Vendi përfitues duhet të mbajë të informuar rregullisht Komisionin mbi progresin e arritur në zbatimin e këtij plani.

12. INTERPRETIMI

1. Në rastin kur një dispozitë konkrete e kësaj Marrëveshjeje shprehet ndryshe, termat e kësaj dispozite duhet të ruajnë të njëjtin kuptim me termat e dispozitave të rregullores kuadër IPA dhe rregullores së zbatimit IPA.

2. Në rastin kur një dispozitë konkrete e kësaj Marrëveshje shprehet ndryshe, referencat e kësaj Marrëveshje do të jenë referencat e kësaj Marrëveshje, të ndryshuar, plotësuar apo zëvendësuar herë pas here.

3. Çdo referencë ndaj rregulloreve të Këshillit apo Komisionit, janë bërë ndaj versionit të tyre, siç është treguar. Nëse kërkohet, modifikimet e këtyre rregulloreve duhet të zhvendosen në këtë Marrëveshje me anë të ndryshimeve.

4. Titujt në këtë Marrëveshje nuk kanë domethënie ligjore dhe nuk ndikojnë në interpretimin e saj.

13. PAVLEFSHMËRIA E PJESSHME DHE BOSHLLËQET E PAQËLLIMSHME

1. Nëse një dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e pavlefshme ose kjo Marrëveshje përmban boshllëqe të paqëllimshme, kjo nuk do të ndikojë vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje. Palët do të zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një dispozitë të vlefshme, e cila është shumë e ngjashme me qëllimin dhe objektivin e dispozitës së pavlefshme.

2. Palët do të mbushin çdo boshllëk të paqëllimshëm nëpërmjet një dispozite, e cila i përshtatet sa më mirë qëllimit dhe objektivit të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me rregulloren kuadër IPA dhe rregulloren e zbatimit IPA.

14. RISHIKIMI DHE NDRYSHIMI

1. Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të jetë subjekt i rishikimeve periodike në kohë, të rëna dakord ndërmjet Palëve.

2. Çdo ndryshim për të cilin është rënë dakord ndërmjet Palëve, do të jetë me shkrim dhe do të jetë pjesë e kësaj Marrëveshjeje. Ndryshime të tilla do të hyjnë në fuqi pasi vendosen ndërmjet Palëve.

15. PËRFUNDIMI

1. Duke respektuar paragrafin 2, kjo Marrëveshje do të përfundojë tetë vjet pas hyrjes në fuqi të saj. Ky përfundim nuk do të përjashtojë mundësinë që Komisioni të bëjë korrigjime financiare në përputhje me nenin 56 të rregullores së zbatimit IPA.

2. Kjo Marrëveshje mund të përfundojë nga secila Palë, duke informuar me shkrim Palën tjetër. Ky përfundim do të ketë efekt gjashtë muaj kalendarikë që nga data e njoftimit me shkrim.

16. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

1. Mosmarrëveshjet që dalin nga interpretimi, përdorimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, në secilën prej dhe të gjitha nivelet e pjesëmarrjes, do të rregullohen miqësisht nëpërmjet konsultimit mes Palëve.

2. Në mungesë të zgjidhjeve miqësore, secila Palë mund ta çojë çështjen për gjykim në përputhje me rregullat fakultative të gjykimit të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit që lidhen me organizatat ndërkombëtare dhe shtetet në fuqi në datën e kësaj Marrëveshjeje.

3. Gjuha që do të përdoret në procedurat e gjykimit do të jetë gjuha angleze. Autoriteti i caktuar do të jetë Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit, pas një kërkese me shkrim të dërguar nga cilado nga Palët. Vendimi i gjykatësit do të jetë i detyrueshëm për të gjitha palët dhe nuk do të ketë proces apelues.

17. NJOFTIME

1. Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshje do të bëhet në formë të shkruar dhe në gjuhën angleze. Çdo komunikim duhet të firmoset dhe duhet të dërgohet si një dokument zyrtar ose me faks.

2. Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshjeje duhet të dërgohet në adresat e mëposhtme:

Për Komunitetin:
Z. Helmuth Lohan
Shef i Delegacionit
Delegacioni i Komisionit Europian në Shqipëri
Qendra e biznesit ABA, kati 17
Rruga: “Papa Gjon Pali II”
Tiranë, Shqipëri
Fax: + 355 4230752

Për vendin përfitues:
Znj. Majlinda Bregu
Ministre e Integrimit Europian
Rruga: “Papa Gjon Pali II”, nr. 3
Tiranë, Shqipëri
Fax +355 4256267

18. GJUHA

Marrëveshja e financimit është hartuar në dy kopje në gjuhën angleze.

19. SHTOJCAT

Anekset A, B dhe C do të përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

20. HYRJA NË FUQI

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit të saj. Në rast se palët nënshkruajnë në ditë të ndryshme, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga Pala e dytë.

Firmosur, për dhe në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në Tiranë, më datë …… nga ……

Znj. Majlinda Bregu
Ministre e Integrimit Europian

Firmosur, për dhe në emër të Komisionit, në Tiranë, më datë …… nga ……

Z. Helmuth Lohan
Shef i Delegacionit

ANEKSI A PROGRAMI NDËRKUFITAR GREQI-SHQIPËRI NËN KOMPONENTIN IPA BASHKËPUNIMI NDËRKUFITAR PËR VITIN 2009

SHTOJCA A1: Propozimi financiar për vitin 2009 të programit ndërkufitar Greqi-Shqipëri, aprovuar me vendimin e Komisionit C(2009) 6493 të datës 24 gusht 2009.

SHTOJCA A2: Programi ndërkufitar 2007-2009 IPA CBC Greqi-Shqipëri aprovuar me vendimin e Komisionit C(2008) 1069 më 19 mars 2008 dhe ndryshuar me vendimin e Komisionit C(2008) 7342 të datës 28 nëntor 2008.

ANEKSI B MARRËVESHJA KUADËR NDËRMJET KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE EUROPIANE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË MË DATË 18 TETOR 2007

ANEKSI C RAPORTIMI

1. Strukturat operuese të vendeve përfituese në një program ndërkufitar duhet t'i dërgojnë Komisionit dhe koordinatorëve kombëtarë respektivë IPA një raport vjetor dhe një raport përfundimtar mbi zbatimin e programit ndërkufitar pas kontrollit të tyre nga Komiteti i Përbashkët i Monitorimit.

Raporti vjetor duhet të dërgohet çdo vit brenda datës 30 qershor; raporti i parë në vitin e dytë që pason adaptimin e programit ndërkufitar.

Raporti përfundimtar duhet të dërgohet jo më vonë se 6 muaj pas mbylljes së këtij programi.

2. Raportet e referuara në paragrafin 1 duhet të përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

a) progresin e bërë gjatë zbatimit të programit ndërkufitar dhe prioritetet në raport me qëllimet specifike, të verifikueshme, me një përcaktim sasior të sasisë, kurdo dhe kudo që kjo të jetë e mundur duke përdorur indikatorët në nenin 94 (1) (d) të rregullores së zbatimit IPA në nivel të akseve prioritare;

b) hapat e ndërmarrë nga struktura operuese për të siguruar cilësinë dhe efektivitetin e zbatimit, në veçanti:

- masat monitoruese dhe vlerësuese, duke përfshirë masat për mbledhjen e të dhënave;
- një përmbledhje të problemeve të rëndësishme të hasura në zbatimin e këtij programi dhe çdo mase të marrë;
- përdorimin e asistencës teknike;

c) masat e marra për të siguruar informimin dhe publicitetin mbi ketë program.

Aty ku është e përshtatshme, informacioni i referuar në pikat (a) deri në (c) të këtij paragrafi mund të jepet në formë të përmbledhur.

Nuk është e nevojshme që informacioni i referuar në pikën (b) të përfshihet nëse nuk ka pasur një ndryshim të rëndësishëm që nga raporti i mëparshëm.

VENDIM I KOMISIONIT

C(2009) 6493 I DATËS 24 GUSHT 2009

PËR ASISTENCËN KOMUNITARE PËR VITIN 2009, NË LIDHJE ME PJESËMARRJEN E SHQIPËRISË NË "PROGRAMIN E BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR IPA GREQI-SHQIPËRI" NËN KOMPONENTIN E BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR NËPËRMJET INSTRUMENTIT TË PARAADERIMIT

Komisioni i Komuniteteve Europiane,

Duke pasur parasysh traktatin themelues të Komunitetit Europian;

Duke pasur parasysh rregulloren e Këshillit (KE) nr.1085/2006 të datës 17 korrik 2006 që vendos Instrumentin për Asistencën e Paraaderimit (IPA)[1] dhe veçanërisht nenin 14 (2) (a);

Meqë:

1. Rregullorja (KE) nr.1085/2006 përcakton objektivat dhe parimet kryesore për asistencën e paraaderimit për vendet kandidate dhe kandidate potenciale.

2. Në përputhje me nenin 7 të rregullores së Komisionit (KE) nr.1085/2006, asistenca duhet të sigurohet mes programeve vjetore ose shumëvjeçare, që mund të vendoset nga vendi, nga një grup vendesh ose nga komponenti. Këto programe duhet të përpilohen në përputhje me kuadrin e përgjithshëm të politikave, referuar në nenin 4 të rregullores së Këshillit nr.1085/2006, dhe dokumentet përkatëse të planifikimit indikativ shumëvjeçar referuar në nenin 6 të kësaj rregulloreje.

3. Këshilli ka vendosur një partneritet aderimi me Shqipërinë[2]. Më 29 shtator 2008, Komisioni miratoi Dokumentin e Planifikimit Indikativ Shumëvjeçar 2008-2010 për këtë vend[3].

4. Në përputhje me nenin 91 të rregullores së Komisionit (KE) nr.718/2007 të datës 12 qershor 2007, në zbatim të rregullores së Këshillit (KE) nr.1085/2006 që vendos Instrumentin për Asistencën e Paraaderimit (IPA)[4] (më pas referuar si rregullorja e zbatimit IPA), Komisioni miratoi më 19 mars 2008 programin shumëvjeçar të bashkëpunimit ndërkufitar Greqi-Shqipëri 2007-2009 (vendimi C(2008)1069, si ndryshim).

5. "Programi ndërkufitar IPA Greqi-Shqipëri" ka si synim sigurimin e asistencës për të rritur standardet e jetesës së popullsisë, duke nxitur një zhvillim lokal të qëndrueshëm në zonat ndërkufitare. Prioriteti i parë do të fokusohet në zhvillimin ekonomik ndërkufitar, prioriteti i dytë do të promovojë zhvillimin e mjedisit dhe burimeve kulturore e natyrore, dhe prioriteti i tretë do të sigurojë asistencë teknike për zbatimin e programit.

6. Meqë vendet pjesëmarrëse nuk janë ende gati për të zbatuar këtë program ndërkufitar në metodën e menaxhimit me përgjegjësi të ndara, ky program do të zbatohet në bazë të dispozitave transitore të përcaktuara në nenin 99 të rregullores së zbatimit IPA; ky vendim si pasojë do t'i përkasë vetëm pjesës së programit ndërkufitar lidhur me Shqipërinë, pjesa e programit ndërkufitar që i përket Greqisë, do të jetë subjekt i një vendimi tjetër.

7. Pjesa e këtij programi ndërkufitar që ka lidhje me Shqipërinë u zbatua për vitin 2007 me vendimin e financimit C(2008) 1069 i datës 19 mars 2008 dhe për vitin 2008 nga vendimi i financimit C(2008)7489 i datës 2 dhjetor 2008. Një vendim i ri financimi duhet të miratohet për të mbuluar zbatimin për vitin 2009.

8. Për vitin 2009, ky vendim është në përputhje me kërkesat e nenit 90 të rregullores së Komisionit (KE, Euroatom) nr.2342/2002 i datës 23 dhjetor 2002 që përcakton rregullat e detajuara për zbatimin e rregullores së Këshillit nr.1605/2002[5] dhe krijon kështu një vendim financimi brenda parashikimit të nenit 75 (2) të rregullores së Këshillit (KE, Euroatom) nr.1605/2002 të datës 25

[1] OJ L 210, 31.7.2006, faqe 82.

[2] Vendim i Këshillit 2008/210/KE i datës 18 shkurt 2008 (OJ L 80, 19.3.2008 faqe 1-17).

[3] C (2008) 5352.

[4] OJ L 170, 29.6.2007, faqe 1.

[5] OJ L 357, 31.12.2002, faqe 1, rregullorja e ndryshuar së fundmi me rregulloren (KE Euroatom) nr.478/2007 (OJ L 111, 28.4.2007, faqe 1).

qershor 2002 mbi rregulloren financiare të aplikueshme mbi buxhetin e Komuniteteve Europiane[1].

9. Masat e parashikuara nga ky vendim janë në përputhje me opinionin e Komitetit të IPA-së.

Ka vendosur si më poshtë:

Neni 1

Miratohet propozimi financiar mbi komponentin e bashkëpunimit ndërkufitar IPA, për vitin 2009, për pjesëmarrjen e Shqipërisë në "Programin e bashkëpunimit ndërkufitar IPA Greqi-Shqipëri", siç parashikohet në aneksin e këtij vendimi.

Pjesa e këtij programi që lidhet me Shqipërinë do të zbatohet në mënyrë të centralizuar në përputhje me parashikimet e nenit 99 të rregullores së zbatimit të IPA-së.

Pjesa e këtij programi që lidhet me Shqipërinë që i korrespondon vitit buxhetor 2009, do të zbatohet nëpërmjet një marrëveshjeje financimi që do të lidhet mes Komisionit dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me marrëveshjen kuadër të lidhur mes palëve më 18 tetor 2007.

Neni 2

Vlera maksimale e kontributit të Komunitetit të dhënë nga IPA-ja për Shqipërinë për pjesëmarrje në "Programin e bashkëpunimit ndërkufitar IPA Greqi-Shqipëri", do të jetë 1 626 968 euro të financuara nga zëri 22.020402 i buxhetit të përgjithshëm të Komuniteteve Europiane për vitin 2009.

Nënshkruar në Bruksel,

PËR KOMISIONIN
Olli Rehn
Anëtar i Komisionit

SHTOJCA A1
PROPOZIMI FINANCIAR PËR VITIN 2009 PËR PJESËMARRJEN E SHQIPËRISË NË "PROGRAMIN NDËRKUFITAR IPA CBC GREQI-SHQIPËRI"

1. IDENTIFIKIMI

Përfituesit	Shqipëria
Numri CRIS	2009/021-154
Viti	2009
Kosto	1 626 968 euro (Vlera totale e kontributit IPA)
Struktura operuese	Në Shqipëri: Ministria e Integrimit Europian
Autoriteti implementues	Komisioni Europian
Data përfundimtare për hyrjen në fuqi të marrëveshjes së financimit:	Jo më vonë se 31 dhjetor 2010
Datat përfundimtare për nënshkrimin e kontratave	2 vjet pas datës së miratimit të marrëveshjes së financimit. Nuk ka afat për projektet e auditimit dhe vlerësimit që mbulohen nga kjo marrëveshje financimi, duke iu referuar nenit 166(2) të rregullores financiare. Këto data vlejnë edhe për bashkëfinancimin kombëtar.
Data përfundimtare për zbatimin e Marrëveshjes	2 vjet nga data përfundimtare e nënshkrimit të kontratave. Këto data vlejnë edhe për bashkëfinancimin kombëtar.
Kodi sektorial	11120, 16061, 32130, 33210, 41010, 43010, 43040, 91010
Zëri buxhetor përkatës	22.020402
Menaxheri përgjegjës i programimit	Drejtoria e Përgjithshme e Zgjerimit Sektori C4
Menaxheri përgjegjës i zbatimit	Delegacioni i Komisionit Europian në Tiranë

[1] OJ L 248, 16.9.2002, faqe 1. Rregullorja e ndryshuar së fundmi me rregulloren e Këshillit (KE, Euroatom) nr.1995/2006 i datës 13 dhjetor 2006 (OJ L 390, 30.12.2006, faqe 1) dhe nga rregullorja e Këshillit (KE, Euroatom) nr.1525/2007 i datës 17 dhjetor 2007 (OJ L 343, 27.12.2007, faqe 9) .

2. PËRMBLEDHJE

2.1 Hyrje

2.1.1 Lidhja me Dokumentin e Planifikimit Indikativ Shumëvjeçar MIPD.

Programi ndërkufitar mes Shqipërisë dhe Greqisë do të kontribuojë në zbatimin e komponentit II të IPA "Bashkëpunimi ndërkufitar" të Dokumentit të Planifikimit Indikativ Shumëvjeçar (MIPD) 2008-2010 për Shqipërinë. Ky program do të sigurojë asistencë për "Stabilitetin demokratik dhe ngritjen e kapaciteteve administrative", "Zhvillimin ekonomik dhe social", "Infrastrukturë dhe asistencë teknike", të identifikuara si fushat më të mëdha të ndërhyrjes në MIPD për Shqipërinë.

2.1.2 Procesi i programimit

Procesi i programimit u zhvillua në periudhën maj-nëntor 2007. U ngrit një grup pune bilaterale duke përfshirë përfaqësues nga autoritetet kombëtare dhe Komisioni Europian.

Takimi i parë i grupit të punës u zhvillua në Selanik, më 22 shtator 2007 dhe u pasua nga 4 takime të tjera në Greqi dhe Shqipëri. Në Kostur, Greqi, u zhvillua një takim, i cili përcaktoi orientimet bazë të programit. Dy takime të tjera u mbajtën në Selanik, në të parin u ra dakord mbi strukturën dhe në të dytin u aprovua drafti i parë i dokumentit të programit. Takimi i katërt u mbajt në Korçë dhe finalizoi përmbajtjen e dokumentit të programit dhe dispozitat zbatuese.

Tri grupe ekspertësh të jashtëm mbështeten grupin e punës për kapituj të veçantë të programit operativ, vlerësimin *ex-ante* dhe vlerësimin strategjik mjedisor.

Në maj 2007, përpara takimeve të grupit të punës, u organizua një konsultim publik për të siguruar një përfshirje të gjerë nga rajonet, sektorët, partnerët socialë dhe aktorët e tjerë.

2.1.2. Lista e zonave përfituese

Zona përfituese përfshin qarqet e Vlorës, Gjirokastrës dhe Korçës në Shqipëri dhe Prefekturat (NUTS III) e Kërkirës, Thesprotisë, Janinës, Kosturit dhe Follorinës në Greqi.

2.1.3 Lista e zonave të afërta (në përputhje me nenin 97 të rregullores së zbatimit IPA)

Zona e Grevenasë në Greqi (NUTS III) është përfshirë në zonat përfituese të programit ndërkufitar IPA Greqi-Shqipëri, si një zonë e afërt me një shpenzim total të lejueshëm jo më shumë se 20% të shpenzimeve të programit.

2.2. Objektivi (at) i përgjithshëm i programit

Objektivi i përgjithshëm i programit është rritja e standardit të jetesës të popullsisë, duke promovuar zhvillimin e qëndrueshëm vendor në territorin ndërkufitar. Programi do të adresojë qëndrueshmëri në komponentët e tij ekonomikë, socialë dhe mjedisorë.

2.3. Akset prioritare, masat e tyre dhe aspektet e tyre specifike në lidhje me zbatimin e buxhetit 2009

2.3.1. Prioriteti I: Forcimi i zhvillimit ekonomik ndërkufitar

Prioriteti I synon të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik nëpërmjet ndërhyrjeve të përbashkëta dhe të lehtësojë marrëdhëniet ndërkufitare.

Masa I.1: Promovimi i sipërmarrjes

Qëllimi specifik i kësaj mase është që lehtësimi i zhvillimit të aktiviteteve ekonomike ndërkufitare nëpërmjet shfrytëzimit të mundësive ekzistuese, potenciale dhe që shfaqen.

Kjo masë do të mbështesë zhvillimin e aksioneve të përbashkëta për bashkëpunimin, shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e aktiviteteve dhe shërbimeve ndërmjet shoqatave profesionale dhe dhomave të tregtisë. Mbështetje e mëtejshme do të jepet për aktivitetet kërkimore dhe studimet për lehtësimin e tregtisë dhe investimeve ndërkufitare, zhvillimin e databejze ndërkufitare dhe lehtësirave për gjetjen e partnerëve të biznesit, zhvillimin e shërbimeve publike për aktivitetet që lehtësojnë tregtinë dhe investimet ndërkufitare, zhvillimin e shoqatave tejkufitare. Ajo do të promovojë, gjithashtu, transferimin e dijeve në fushat relevante të biznesit dhe do të promovojë aktivitete të përbashkëta dhe panaire.

Masa I.2: Promovimi i turizmit të qëndrueshëm

Qëllimi specifik i kësaj mase është mbështetja e aktiviteteve të përbashkëta ndërkufitare që mbështesin turizmin dhe që vënë në punë trashëgiminë ekzistuese natyrore dhe kulturore.

Kjo masë do të mbështesë zhvillimin dhe promovimin e: planifikimit të përbashkët territorial turistik, markave rajonale dhe nismat e marketingut të përbashkët, standardeve për shkëmbimet, sistemet e përbashkëta të tarifimit, trajnimet e përbashkëta, grupeve tematike turistike dhe i pikë-referimeve tematike, rrjeteve të ekoturizmit, aktiviteteve në qiell të hapur, ndërthurjes së zejtarisë vendore me turizmin.

Masa I.3: Aktivitetet njerëzit për njerëzit

Qëllimi specifik i kësaj mase është mbështetja e aktiviteteve të përbashkëta ndërkufitare të shkallës së vogël që fokusohen direkt në ndërveprimin e popullsisë vendore.

Kjo masë do të mbështesë këto aktivitete: bashkëpunimin e universiteteve dhe instituteve arsimore për zhvillimin e kurseve të përbashkëta, rritjen e lëvizshmërisë së studentëve, zhvillimin e formimit profesional dhe kualifikimit profesional, transferimin e dijes që lidhet me çështje të shëndetit dhe mirëqenies sociale, zhvillimin e koncepteve novatore dhe i mësimit gjatë gjithë jetës, zhvillimin e rrjeteve për shkëmbimin e kulturës së jetesës, trajnime, sport, media vendore, pjesëmarrje publike, aktivitete qytetare; zhvillimin e kujdesit parësor shëndetësor të lëvizshëm ndërkufitar, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse, zhvillimin e hallkave për shërbimet shëndetësore vendore dhe lokale dhe të kërkim-shpëtimit për reagime të përbashkëta ndaj emergjencave shëndetësore, mbështetje për përdorimin e teknologjive të reja dhe ICT në bashkëpunimin ndërkufitar.

Masa I.4: Lehtësimi i aksesueshmërisë kufitare nëpërmjet infrastrukturës së shkallës së vogël

Qëllimi specifik është mbështetja e ndërhyrjeve të shkallës së vogël që kontribuojnë në procedurat e shpejta dhe efikase të kalimit të kufirit.

Kjo masë do të mbështesë këto aktivitete: mbështetje për përmirësimin e infrastrukturës së shkallës së ulët në stacione kufitare, përmirësimin e procedurave të sigurisë që lidhen me lëvizjen e personave, kapitalit dhe mallrave, mbështetje për ndërhyrje ICT për të lehtësuar dhe përshpejtuar kontrollet në kufi, zhvillimin e procedurave të koordinuara doganore, mbështetje për zhvillimin e studimeve me qëllim lehtësimin dhe përshpejtimin e kontrolleve në kufi, eksplorimin e potencialit për transportin publik.

2.3.2. Prioriteti II: Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit dhe burimeve natyrore dhe kulturore

Prioriteti II synon të promovojë aksionet e përbashkëta për mbrojtjen e mjedisit dhe mobilizimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

Masa II.1: Promovimi dhe mbrojtja e burimeve mjedisore të zonës

Qëllimi specifik i kësaj mase është mbështetja e ndërhyrjeve që mbrojnë mjedisin dhe zbutin impaktet mjedisore që lidhen me zhvillimin ekonomik.

Kjo masë do të mbështesë këto aktivitete: zbatimin e vlerësimeve tejkufitare të impaktit në mjedis, zhvillimin e programeve trajnuese dhe ndërgjegjësuese dhe i certifikatave rajonale, kryesisht në fushat e ekoturizmit, bujqësisë organike dhe energjisë së rinovueshme, zhvillimin e rrjeteve dhe planeve për menaxhimin dhe ruajtjen e burimeve ujore, zhvillimin e lidhjeve në planifikimin mjedisor ndërkufitar të organeve publike kompetente, regjistrimin dhe vlerësimin e elementeve të rrezikuara të mjedisit natyror, zhvillimin e strategjive ndërkufitare për menaxhimin e mbetjeve dhe ujërave të ndotura, veçanërisht në lidhje me lumenjtë, rritjen e bashkëpunimin në fushën e zonave të mbrojtura, rritjen e koordinimit dhe trajnimit të përbashkët për rreziqet natyrore, paralajmërimin e hershëm dhe mekanizmat e reagimit, zhvillimin e qasjeve novatore në përdorimin e tokës dhe zhvillimin urban.

Masa II.2: Promovimi dhe mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore e zonës

Qëllimi specifik i kësaj mase është të promovojë dhe të mbrojë trashëgiminë natyrore dhe kulturore të zonës.

Kjo masë do të mbështesë këto aktivitete: promovimin dhe përmirësimin e monumenteve natyrore dhe kulturore përfshi monumentet fetare, ndërtesat tradicionale dhe vendet historike, promovimin dhe marketingu i rajonit drejt grupeve të veçanta të interesit, zhvillimi i mjeteve ICT për promovimin dhe mbrojtjen e monumenteve natyrore dhe kulturore, zhvillimin e mjeteve të përbashkëta në fushën e mbrojtjes dhe restaurimit të peizazheve kulturore, promovimin e arkitekturës vendore, zhvillimi i qasjeve novatore në përdorimin e tokës dhe zhvillimin e ndërtimeve, veçanërisht për ndërtimet e argëtimit dhe kohës së lirë, dhe për zonat e ndjeshme kulturore, zhvillimin e aktiviteteve regjistrojnë dhe promovojnë shkëmbimin e veçorive tradicionale, si: muzika, folklori përfshi evenimentet e përbashkëta kulturore.

2.3.3. Prioriteti III: Asistenca teknike

Prioriteti III për asistencën teknike do të fokusohet në aktivitete që sigurojnë menaxhimin bazë për zbatimin e programit dhe do të zbatojnë aktivitetet shoqëruese në mbështetje të gjenerimit dhe krijimit të projekteve ndërkufitare dhe partneriteteve me cilësi të lartë dhe të orientuar drejt rezultateve. Asistenca teknike duhet të trajtojë, gjithashtu, nevojën e veçantë për informim dhe komunikim për projektet ndërkufitare.

Plani kohor indikativ dhe shuma indikative për zbatimin e masave:

Masat e prioritetit I dhe II do të zbatohen nëpërmjet skemave të granteve. Pritet që dy skema grantesh, një për secilin prioritet, të fillohen në një ftesë të vetme për propozime në 2010 për një shumë indikative 861.336 euro (prioriteti I) dhe 861.336 euro (prioriteti II) me një shumë indikative prej 787 994 € (prioriteti I) dhe 787 994 € (prioriteti II). Do të aplikohen kriteret bazë të përzgjedhjes dhe dhënies së granteve të përcaktuara në udhëzuesin praktik për procedurat e kontraktimit për aktivitetet e jashtme të Komuniteteve Europiane (PRAG). Kriteret e përzgjedhjes dhe të dhënies së granteve do të përcaktohen në ftesën për projektpropozime, paketën e aplikimit (Udhëzuesi për aplikantët).

Prioriteti "Asistencë teknike" do të zbatohet pa ftesë për projektpropozime, por individualisht nëpërmjet marrëveshjeve direkte të granteve nëpërmjet Komisionit Europian dhe autoriteteve kombëtare respektive, në përputhje me nenin 168 1. (c) të rregullores së zbatimit të rregullores financiare, që konsideron autoritetet kombëtare, si p.sh., koordinatorin për bashkëpunimin ndërkufitar (CBC), sipas nenit 22 (b) të rregullores së zbatimit IPA dhe strukturat operative, që kanë në dorë *de facto* një situatë monopoliste për zbatimin e programeve ndërkufitare. Prokurimi i shërbimeve, pajisjeve ose punimeve nga përfituesit e granteve direkte është i mundur sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në marrëveshjen e grantit dhe në përputhje me nenin 120 të rregullores financiare dhe nenit 184 të rregullores së zbatimit të rregullores së financimit. Marrëveshje direkte granti mund të nënshkruhen sapo të nënshkruhet marrëveshja financiare. Alokimi IPA për prioritetin "Asistencë teknike" do të plotësohet nga një shumë totale prej 28712 € të bashkëfinancimit kombëtar të siguruar nga autoritetet e Shqipërisë.

2.4. Vështrim mbi eksperiencën e kaluar dhe të tanishme ndërkufitare, duke përfshirë mësimet e nxjerra dhe koordinimin e donatorëve.

- Eksperienca e kaluar dhe e tanishme

Bashkëpunimi ndërkufitar në zonën kufitare Shqipëri-Greqi ka nisur me programet INTERREG II (1994-1999) dhe PHARE CBC. Këto programe ofruan mundësinë e parë të madhe për një bashkëpunim institucional ndërmjet dy vendeve. Procesi i bashkëpunimit ndërkufitar vazhdoi dhe u forcua në kuadër të programit CIP INTERREG IIIA Greqi-Shqipëri 2000-2006. Ky program u hartua bashkërisht nga Greqia dhe Shqipëria dhe u rishikua për të reflektuar situatën që ndryshonte me shpejtësi në zonën kufitare përfituese dhe ndryshoi statusin e tij në një program të përbashkët fqinjësie Greqi-Shqipëri 2004-2006. Asistenca e fondeve strukturore (ERDF) arriti në 90 milionë € dhe Shqipërisë iu ofrua asistencë nëpërmjet instrumentit CARDS. Programi i fqinjësisë Greqi-Shqipëri 2004-2006 u aprovua në fillim të vitit 2005 dhe ftesa e parë për projektpropozime u bë në qershor 2006.

Struktura e dyfishtë e fondeve ERDF dhe CARDS bëri të vështirë koordinimin ndërmjet projekteve dhe partnerëve dhe mundësia për të hartuar dhe zbatuar projekte të përbashkëta ishte e

limituar. Programi i fqinjësisë bëri të mundur që të dyja vendet të afroheshin me njëri-tjetrin. U përmirësua bashkëpunimi nëpërmjet takimeve bilaterale të Komitetit të Monitorimit dhe Komitetit Drejtues dhe shkëmbimi i informacionit dhe vendimmarrja u zhvillua ndjeshëm. U ngrit një Sekretariat i Përbashkët me një staf prej 4 personash, 2 nga Shqipëria dhe 2 nga Greqia. Nevoja për ngritjen e strukturave të reja në Komitetin e Përbashkët të Monitorimit dhe Komitetin e Përbashkët të Vlerësimit vonoi zbatimin e programit. Megjithatë, ngitja e strukturave të përbashkëta ndihmoi vendet të përgatitnin zbatimin e periudhës së programimit 2007-2013.

- Mësime të nxjerra

Pjesa më e madhe e iniciativave ndërkufitare filloi vetëm së fundmi, duke e bërë të parakohshme përcaktimin "mësime të nxjerra". Nuk janë shpallur ende ftesat për projektpropozime për bashkëpunimin ndërkufitar IPA 2007 mes Greqisë dhe Shqipërisë. Marrëveshja financiare sapo është nënshkruar. Sidoqoftë, mund të nënvizohen çështjet e mëposhtme nga eksperienca e programeve të fqinjësisë dhe bashkëpunimit ndërkufitar në vendet e Ballkanit Perëndimor:

- Projektet e fokusuara në mbrojtjen e mjedisit reflektojnë prioritetet e përcaktuara nga institucionet qendrore dhe vendore, duke siguruar një përputhje të fortë mes prioriteteve të zhvillimit kombëtar dhe lokal.

- Ftesat e vogla për projektpropozime për aktivitetet ndërkufitare të filluara në programet e kaluara ndërkufitare treguan një kapacitet të ulët në përgatitjen e projekteve në pjesën më të madhe të përfituesve. Kjo mund të dëmtojë zbatimin e programeve. Trajnime të veçanta të aplikantëve potenciale do të jetë e rëndësishme gjatë programit.

- Disa bashki kanë pasur rol udhëheqës në iniciativat e kaluara dhe aktuale të bashkëpunimit ndërkufitar. Këto bashki duhet të kenë një rol kyç gjatë zbatimit të programit (transferimi i ekspertizës etj.).

Në vazhdim, një vlerësim i pavarur mbi programet e bashkëpunimit ndërkufitar nën PHARE u krye nga konsorciumi MWH. Eksperienca ka treguara që parakushtet për një zbatim efektiv përfshijnë përveç të tjerave, bashkëpunimin e ngushtë mes vendeve pjesëmarrëse në nivel politik dhe operacional:

- Bashkëpunimi ndërkufitar mes ministrive të linjës dhe marrëdhëniet efektive të punës mes organizatave që lidhen me to.

- Funksionimi i autoriteteve të zhvillimit rajonal dhe vendor, me stafin e duhur në një klimë të qëndrueshme.

- Marrëdhënie të ngushta pune mes institucioneve rajonale dhe delegacioneve përkatëse të Komisionit.

Funksionimi i bashkëpunimit ndërkufitar mes organizatave respektive të sektorit privat, si: dhomat e tregtisë, shoqatave të kompanive dhe OJF-ve.

- Koordinimi i donatorëve

Qeveria e Shqipërisë është përfshirë në procesin e koordinimit të donatorëve mes sistemit të integruar të planifikimit (IPS), një mekanizëm që ka si qëllim reformimin e mënyrës se si fondet publike (të brendshme dhe të huaja) menaxhohen. IPS-ja u aprovua nga qeveria në nëntor 2005 dhe duhet të përcaktojë një kuadër strategjik koherent, duke siguruar që politikat kryesore shqiptare dhe proceset financiare funksionojnë në një mënyrë koherente, efikase dhe të integruar. Nën CARDS 2004, një kontribut i KE-së iu dha fondit të besimit të Bankës Botërore për zbatimin e IPS-së.

Qeveria pret, gjithashtu, përmirësimin e procesit të konsultimit mes komunitetit të donatorëve dhe përputhjen e ndihmës ndërkombëtare me prioritetet kombëtare mes Departamentit të Koordinimit të Strategjive dhe Donatorëve, në Këshillin e Ministrave. Ministri i Integrimit Europian është emëruar, gjithashtu, koordinator kombëtar i IPA-së.

Delegacioni i Komisionit Europian, në rolin e tij si drejtues i Sekretariatit Teknik të Donatorëve, ka lehtësuar koordinimin duke mbajtur të dhënat e projekteve të të gjithë donatorëve që në vitin 2003. Roli i koordinimit të donatorëve është në proces të transferimit gradual drejt autoritetit. Marrëdhënie të ngushta pune janë mbajtur me organizatat financiare ndërkombëtare (EIB, EBRD, Banka Botërore, KfW).

Në përputhje me nenin 20 të rregullores IPA dhe të nenit 6(3) të rregullores së zbatimit IPA, Komisioni Europian ka marrë mendimin e përfaqësuesve të vendeve anëtare të BE-së dhe institucioneve financiare ndërkombëtare në Shqipëri për të dhënë komentet e tyre në lidhje me draftin e programit ndërkufitar dërguar Komisionit.

2.5. Çështje horizontale

Aplikimet e përbashkëta duhet të përfshijnë të dyja anët e kufirit dhe të përmbushin kriteret e mëposhtme:

- të përfitojnë partnerë nga të dyja anët e kufirit;
- të mbështetin krijimin e lidhjeve ndërmjet institucioneve dhe organizatave nga të dyja anët e kufirit;
- të inkurajojnë pjesëmarrje të barabartë të grave dhe grupeve të margjinalizuara;
- të jenë të qëndrueshëm nga ana mjedisore.

Partnerët e projektit duhet të ngrenë mekanizma bashkëpunimi për të cilat kanë rënë dakord për të sinkronizuar projektet e përbashkëta përgjatë zbatimit të tyre.

2.6. Të dhëna

	N*	**N+1 (kumulative)**	**N+2 (kumulative)**
Numri i ftesave për projekt propozime të filluara në Shqipëri	0	1	1
Numri i granteve direkte (prioriteti "Asistenca teknike") në Shqipëri	0	1	1
Niveli i kontraktimit (%) në Shqipëri	0	100	100

* "N" është data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së financimit.

2.7. Hapat për decentralizimin e menaxhimit të fondeve të BE-së pa kontrolle *ex-ante* nga Komisioni

Në përputhje me nenin 8(4) (c) të rregullores së implementimit IPA, vendet përfituese duhet të hartojnë një plan me etapa indikative dhe limite kohore për të arritur decentralizimin pa kontrolle *ex-ante* nga Komisioni.

Në Shqipëri, Këshilli i Ministrave vendosi në shtator 2007 ngritjen e strukturave, autoriteteve dhe përgjegjësive për zbatimin e IPA-së në sistemin e zbatimit të decentralizuar (DIS). Në nëntor 2007, Ministria e Financave i paraqiti Drejtorisë së Përgjithshme për Zgjerim një propozim për funksionimin e Njësisë Qendrore për Financim dhe Kontraktim (CFCU). Një projekt asistence teknike i IPA-së 2007, ka filluar aktivitetet e tij në janar 2009. Plani indikativ i aktiviteteve propozuar nga konsulenti i kontraktuar mund të ndahet në dy faza: në fazën e parë, me zgjatje një vit, konsulenti do të mbështesë përgatitjen e suksesshme për në sistemin e zbatimit të decentralizuar nën komponentin I dhe II; në fazën e dytë, në një periudhë 6-mujore, konsulenti do të testojë si strukturat e ngritura ashtu edhe përputhshmërinë e tyre me kriteret e IPA-së për sistemin e zbatimit të decentralizuar (DIS) dhe të zhvillojë trajnime. Me fillimin e këtij projekti, palës shqiptare iu kërkua të miratojë një plan për DIS-in dhe të ngrejë SPO-në, oficerët e projekteve në ministritë e linjës.

3. Buxheti i vitit 2009

3.1. Tabela financiare indikative për vitin 2009 për Shqipërinë

	Asistenca BE – IPA		**Kontributi kombëtar**		**Totali (IPA plus kontributi kombëtar)**	
	EURO (a)	**(%)**	**EURO (b)**	**(%)[1]**	**EURO (c) = (a) + (b)**	**(%)[2]**
Prioriteti 1	732.136	85	129.200	15	861.336	45
Prioriteti 2	732.136	85	129.200	15	861.336	45
Prioriteti 3	162.696	85	28.712	15	191.408	10
TOTALI	1.626.968	85	287.112	15	1.914.080	100%

3.2. Parimi i bashkëfinancimit i aplikueshëm për projektet të financuara nga programi

Kontributi i Komunitetit është përllogaritur në raport me shpenzimet e lejueshme, të cilat për Shqipërinë në kuadër të programit ndërkufitar Greqi-Shqipëri është bazuar në shpenzimet totale.

Aplikohen dispozitat e nenit 90 të rregullores së zbatimit IPA.

Përqindja e kontributit të Komunitetit për këtë program për Shqipërinë arrin në 85%. Norma e kontributit të Komunitetit për këtë program është 85%. Bashkëfinancimi për prioritetin I dhe II do të sigurohet nga përfituesit përfundimtarë të grantit dhe mund të jenë nga fonde publike dhe private. Përfituesit përfundimtarë të grantit duhet të kontribuojnë me një minimum prej 15% të kostos totale të lejueshme të projektit, si për projekte investimesh ashtu edhe për ngritjen e institucioneve. Bashkëfinancimi nën aksin prioritar III do të sigurohet nga autoritetet kombëtare.

4. Marrëveshjet për implementimin

4.1. Metoda e implementimit

Programi ndërkufitar Greqi-Shqipëri do të zbatohet në përputhje me dispozitat e nenit 99 (procedura të ndërmjetme) të rregullores së zbatimit të IPA-së.

Pjesa e programit për Shqipërinë do të implementohet në bazë të centralizuar nga Komisioni Europian në përputhje me nenit 53a të rregullores financiare[3] dhe që i përgjigjet rregullave të rregullores së zbatimit[4].

Në rast të menaxhimit të centralizuar, roli i Komisionit në përzgjedhjen e projekteve në kuadër të programeve ndërkufitare është përcaktuar në nenin 140 të rregullores së zbatimit IPA.

4.2 Rregulla të përgjithshme për prokurimin dhe procedurat e dhënies së grantit

Prokurimi duhet të zbatojë dispozitat në pjesën II, titulli IV të rregullores financiare, si dhe ato në pjesën II, titulli III, kapitulli 3 në rregulloren e zbatimit[5], si dhe rregullat dhe procedurat për kontratat e shërbimeve, pajisjet dhe punimet të financuara nga buxheti i përgjithshëm i Komuniteteve Europiane për qëllime bashkëpunimi me vendet e treta, aprovuar nga Komisioni në datë 24 maj 2007 (C(2007)2034).

Procedurat e dhënies së grantit do të ndjekin rregullat e pjesës së parë, titulli VI në rregulloren financiare dhe pjesën e parë, titulli VI në rregulloren e zbatimit.

Sipas rastit, autoriteti kontraktues do të përdorë, gjithashtu, formatin standard dhe modelet që lehtësojnë aplikimin e rregullave të mësipërme, të cilat ndodhen në "Udhëzuesin praktik të procedurave të kontraktimit për veprimet e huaja të KE-së" (Udhëzuesi praktik) publikuar në faqen e internetit të EuropeAid[6] në ditën e fillimit të procedurave të prokurimit ose dhënies së grantit.

---

[1] Shprehja në % e totalit IPA plus kontributit kombëtar (kolona (c)).

[2] Shprehja në % e totalit të kolonës (c). Jep raportin relativ të secilit prioritet, duke iu referuar fondit total (IPA + Kombëtar).

[3] OJ L 248, 16.9.2002, faqe 1, rregullorja e amenduar nga rregullorja (EC, Euratom) nr.1995/2006 (OJ L 390, 30.12.2006, faqe 1) dhe nga rregullorja e Këshillit (EC, Euroatom) nr.1525/2007 datë 17 dhjetor 2007 (OJ L 343, 27.12.2007, faqe 9).

[4] OJ L 357, 31.12.2002, p. 1, rregullorja e amenduar së fundmi nga rregullorja (EC, Euratom) nr.478/2007 (OJ L 111, 28.4.2007, faqe 1).

[5] Shiko shënimet 2 dhe 3.

[6] Adresa aktuale: http://ec.europa.eu/europeaid/work/procedurës/implementation/practical_guide/index_en.htm

4.3. Vlerësimi i ndikimit mjedisor dhe mbrojtja e natyrës (në raste të nevojshme)

Të gjitha investimet do të realizohen në përputhje me legjislacionin përkatës të Komunitetit mbi mjedisin.

Procedurat për vlerësimin e rolit të mjedisit, siç janë përcaktuar në direktivën EIA[1] aplikohen tërësisht për të gjitha projektet e investimeve nën instrumentin IPA. Nëse direktiva EIA nuk është transpozuar ende plotësisht procedurat do të jenë të ngjashme me ato të përcaktuara në direktivën e sipërpërmendur.

Nëse një projekt ka të ngjarë të ketë ndikim në vendet me rëndësi për ruajtjen e natyrës, një vlerësim i saktë i ruajtjes së natyrës duhet të bëhet, ekuivalente me atë të nenit 6 të direktivës së habitatit, dhe duhet të dokumentohet[2].

5. Monitorimi dhe vlerësimi

5.1. Monitorimi

Implementimi i programit ndërkufitar do të monitorohet nga Komiteti i Përbashkët i Monitorimit, sipas nenit 110 të rregullores së zbatimit IPA, ngritur nga vendet përfituese, i cili përfshin dhe përfaqësues të Komisionit.

Në Shqipëri, Komisioni mund të ndërmarrë çdo veprim që ai e konsideron si të nevojshëm për të monitoruar programin në fjalë.

5.2. Vlerësimi

Programet do të jenë subjekt i vlerësimeve në përputhje me nenin 141 të rregullores së zbatimit IPA, me qëllimin për të përmirësuar cilësinë, efektivitetin dhe përputhshmërinë e asistencës nga fondet e Komunitetit dhe strategjinë e implementimit të programeve ndërkufitare.

6. Auditi, kontrolli financiar, masat antimashtrim

Llogaritë dhe aktivitetet e të gjitha palëve të përfshira në implementimin e këtij programi, si dhe të gjitha kontratat dhe marrëveshjet që implementojnë këtë program, janë subjekt, nga njëra anë, i mbikëqyrjes dhe kontrollit financiar të Komisionit (duke përfshirë edhe Zyrën Europiane të Antimashtrimit), të cilat mund të zhvillojnë kontrolle, kur e gjykon të arsyeshme ose vetë, ose nëpërmjet një audituesi të jashtëm, nga ana tjetër, audituesve nga Gjykata Europiane e Llogarive. Kjo përfshin masa të tilla, si p.sh., verifikimin *ex-ante* të tenderimit dhe kontraktimit, të zhvilluara nga delegacionet në vendeve përfituese.

Me qëllim për të siguruar një mbrojtje efikase të interesave financiare të Komunitetit, Komisioni (duke përfshirë Zyrën Europiane të Antimashtrimit) mund të ushtrojë kontrolle në vend dhe inspektime në përputhje me procedurat e parashikuara në rregulloren e Këshillit (EC, Euratom) 2185/96[3].

Kontrollet dhe auditimet e përshkruara më lart, janë të aplikueshme për të gjithë kontraktuesit, nënkontraktuesit dhe përfituesit e grantit, të cilët kanë përfituar fonde nga Komuniteti.

7. Ndryshime të kufizuara

Ndryshime të limituara në implementimin e këtij programi që kanë ndikim mbi elementet thelbësore, të listuara në nenin 90 të rregullave të implementimit të rregullores financiare, e cila është e një natyrë indikative[4], mund të ndërmerren nga zyrtari i autorizuar nga Komisioni në delegacion (AOD), mund të ndërmerren nga zyrtari autorizues i Komisionit me anë të delegimit (AOD), ose nga zyrtari autorizues i Komisionit me anë të nëndelegimit (AOSD), në përputhje me pushtetin e deleguar nga ana e AOD-së, në përputhje me parimet e menaxhimit të mirë financiar pa qenë i nevojshëm një vendim ndryshimi financiar.

---

[1] Direktiva e Këshillit 85/337/EEC datë 27 qershor 1985 mbi vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private mbi mjedisin (OJ L 175, 5.7.1985, faqe 40). Direktiva e amenduar së fundmi nga rregullorja 2003/35/EC, OJ L 156, 25.6.2003, faqe 17.

[2] Direktiva e Këshillit 92/43/EEC datë 21 maj 1992 mbi mbrojtjen e habitateve natyrore dhe të faunës dhe florës së egër (OJ L206, 22.7.1992). Direktiva e amenduar së fundmi nga rregullorja (EC) nr.1882/2003 (OJ L284, 31.10.2003, faqe 1)

[3] Rregullorja e Këshillit (EC, Euratom) 2185/96 datë 11 nëntor 1996, OJ L 292; 15.11.1996; faqe 2.

[4] Këto elemente thelbësore janë të natyrës indikative, shuma indikative e thirrjes për propozime dhe, për prokurimet, numri indikativ, lloji kontratave i parashikuar dhe itinerari indikativ për lançimin e procedurave të prokurimit.